REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE, NAUKU I TEHNOLOGIJU
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE AND TECHNOLOGY

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVES

# UDHËZUES PRAKTIK PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS

## Fusha e kurrikulës

# ARTET




*Mars, 2014*

***Përgatitur nga:***

*Prof. Ass. Besa Luzha, UP, Fakulteti i Arteve - Dega e Artit Muzikor (DAM)*

*Mr. Violeta Krasniqi, mësimdhënëse e angazhuar, Fakulteti i Arteve (DAM)*

**Koordinuar nga:**

*Selim Mehmeti, Instituti Pedagogjik i Kosovës*

*Hajrije Devetaku - Gojani, Instituti Pedagogjik i Kosovës*

*Shqipe Gashi, zyrtare për kurrikula në MASHT*

**Lektor:**

*Bekim Morina, Instituti Pedagogjik i Kosovës*

**Botimin e mbështeti:**

*Zyra për trajnime në MASHT*

***Dizajni dhe faqosja:***

*'Blendi', Prishtinë*

*Prishtinë, mars 2014*

**PËRMBAJTJA**


**Shkurtesat ........................................................................................................................ 6**

**1. HYRJE ........................................................................................................................ 7**

**2. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULA BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË.......................................................................................................................11**

2.1. Qëllimet e arsimit parauniversitar ........................................................................................ 13

2.2. Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore ... .15

2.3. Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit ............................................................... 19

2.3.1. Rezultatet e të nxënit për shkallë – kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre....................... 19

2.3.2. Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe përmbajta mësimore ............................ 24

2.3.3. Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore (RNL) brenda shkallës kurrikulare.................................................................................................... 28

**3. ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KURRIKULËS SË RE ....................................................................... 33**

3.1. Plani mësimor ...........................................................................................................33

3.2. Plani për shkallë të kurrikulës ......................................................................................35

3.3. Plani vjetor ................................................................................................................38

3.4. Plani dymujor .............................................................................................................46

3.5. Plani javor ..................................................................................................................53

3.6. Plani i orës mësimore ..................................................................................................57

3.7 Çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare /lëndëve mësimore…….59

**4. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI DHE INSTRUMENTET E SAJ ............................................................................................... 61**

4.1. Metodologjia e mësimdhësnies në funksion të KKK ................................................... 61

4.2. Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre) ................................................ 68

4.3. Aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit ..................................................... 71

4.4. Bashkëpunimi i mësimdhënësve si domosdoshmëri për zbatim të kurrikulës së re ....................... 78

**Shtojca ........................................................................................................................ 80**

Shtojca 1 : Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit..........81

Shtojca 2 : Modele të planifikimeve të përgatitura nga mësimdhënësit ..............................................82

Shtojca 3 : Pakoja e instrumenteve për planifikimin mësimor ..................................................111

**Burimet dhe literatura ..................................................................................................... 119**

| | SHKURTESAT |
|---|---|
| **KKK** | Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës |
| **KB** | Kurrikula Bërthamë |
| **FK** | Fushë Kurrikulare |
| **SHK** | Shkallë Kurrikulare |
| **RNSH** | Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare – kompetenca |
| **RNF** | Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare |
| **RNL** | Rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore |
| **PV** | Plan Vjetor |
| **PD** | Plan Ditor |
| **OM** | Orë Mësimore |
| **POM** | Plani i Orës Mësimore |
| **TM** | Teknikë Mësimore |
| **KSH** | Kalendari Shkollor |
| **KV** | Kalendari Vjetor |
| **MASHT** | Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë |
| **IPK** | Instituti Pedagogjik i Kosovës |
| **DKA** | Drejtoria Komunale e Arsimit |

# I. HYRJE

Udhëzuesi për zbatimin e Kurrikulës së Re është doracak, i cili mbështet implementimin e filozofisë së Kornizës së Kurrikulës së Kosovës në praktikë. Ky udhëzues është vazhdimësi e dokumenteve kurrikulare, të cilat në mënyrë hierarkike e ndihmojnë dhe e bëjnë të zbatueshëm njëra-tjetrën. MASHT-i, pas Kornizës së Kurrikulës së Kosovës (KKK), i ka hartuar kurrikulat bërthamë (KB) për të vazhduar më pas, në bashkëpunim me IPK-në me Udhëzuesin për zbatimin e Kurrikulës së Re.

Udhëzuesi ofron informata për jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, për respektimin parimeve të kurrikulës, kuptimin e zbërthyeshmërisë së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare - kompetenca dhe për fushën e kurrikulës së Arteve për tri nivelet formale të arsimit parauniversitar në planifikime mësimore. Gjithashtu, udhëzuesi ofron aspekte metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe të zbatimit të kurrikulës së re, aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit të arritjeve të nxënësve. Aspektet metodologjike të planifikimit dhe të zbatimit të kurrikulës se re dhe të vlerësimit të arritshmërive të nxënësve mbështeten në praktikat e suksesshme të shkollës.

### Rëndësia e udhëzuesit

Udhëzuesi mbështet zbatimin e KKK-së, respektivisht KB-ve, në shkollë. Shembujt e modeleve praktike të planifikimeve mësimore, të metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit, ndihmojnë ndërlidhjen e kurrikulës me punën mësimore në shkollë.

### Qëllimi i udhëzuesit

Meqenëse mësimdhënësit janë agjentët kryesorë të zbatimit të filozofisë së KKK-së, udhëzuesi ka për qëllim ngritjen profesionale të mësimdhënësve për të kuptuar dhe zbërthyer KKK-në, respektivisht KB-të, në planifikime mësimore, në strategji e teknika të mësimdhënies, të nxënit dhe të vlerësimit të arritshmërive të nxënësve dhe në vetëvlerësim të procesit mësimor të organizuar nga vetë mësimdhënësit, duke e ndihmuar zhvillimin e kompetencave të caktuara te nxënësit e moshës që mbulojnë Kurrikulat Bërthamë.

### Përdorimi i udhëzuesit

Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i trajnerëve për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të mësimdhënësve të fushës së Arteve në zbatimin e KKK-së, respektivisht të KB-ve, për tri nivelet e arsimit parauniversitar. Më pas ky udhëzues përdoret nga vetë mësimdhënësit, gjatë punës së pavarur në zbatimin e KB-ve.

**Rezultatet e pritura nga përdorimi i udhëzuesit**

Duka pasur parasysh çështjet që trajtohen në udhëzues dhe strategjitë që praktikohen gjatë trajnimit, pritet që mësimdhënësit të arrijnë këto rezultate:

- Të identifikojnë qasjet e arritshmërisë së qëllimeve të arsimit;
- Të identifikojnë qasjet e respektimit të parime në procesin arsimor, duke përfshirë planifikimet, metodologjitë dhe vlerësimin;
- Të identifikojnë elementet e domosdoshme të përbërjes së planifikimeve mësimore për zbatueshmëri të KB-ve;
- Të përgatisin modele të planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-ve.
- Të përgatisin modele të strategjive të mësimdhënies dhe të të nxënit, duke respektuat parimet e KKK-së, KB-ve;
- Të përgatisin dhe shfrytëzojnë materialeve të ndryshme mësimore;
- Të zbatojnë strategji, teknika dhe instrumente të vlerësimit konform parimeve të kurrikulës;
- Të zbatojnë strategji të bashkëpunimit kolegial brenda dhe jashtë shkollës, si kurorëzim i suksesit të shkollës.

**Organizimi i udhëzuesit**

Udhëzuesi përbëhet prej katër kapitujve dhe shtojcës. Në secilin kapitull elaborohen çështje që i ndihmojnë mësimdhënësit të kuptojnë ecurinë e zbërthimit të KKK-së, respektivisht të KB-ve, në praktikën shkollore dhe t'i bëjnë ata agjentë të ndryshimeve.

Në kapitullin e parë – **Hyrje,** trajtohen rëndësia e udhëzuesit, qëllimi i udhëzuesit, përdorimi dhe përdoruesit e udhëzuesit, rezultatet e pritura nga përdoruesit e udhëzuesit dhe organizimi i udhëzuesit.

Në kapitullin e dytë - **Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë – zbatimi në praktikë**, trajtohen çështje që ndihmojnë jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, respektimin e parimeve të kurrikulës në procesin e arsimit në shkollë, kuptimin e zbërthyeshmërisë së rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe për fusha kurrikulare të shkallëve kurrikulare në planifikime mësimore.

Në kapitullin e tretë - **Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re**, trajtohen çështje të planifikimeve mësimore, duke integruar elemente domosdoshme të KB-ve, çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacionin në mes të fushave kurrikulare dhe bashkëpunimin kolegial në funksion të zbatimit të KB-ve.

Në kapitullin e katërt – **Metodologjia e mësimdhënies, materialet mësimore, vlerësimi dhe instrumentet e saj,** trajtohen strategji të mësimdhënies dhe të të nxënit, duke përfshirë metoda, teknika të mësimdhënies dhe të të nxënit të suksesshëm, përgatitjen dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore. Trajtohen metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit të arritjeve të nxënësve, respektivisht kompetencat.

Shtojca përmban planifikime dhe materiale të mësimdhënies dhe të vlerësimit, të punuara nga mësimdhënësit.

# II. KORNIZA E KURRIKULËS SË KOSOVËS DHE KURRIKULAT BËRTHAMË – ZBATIMI NË PRAKTIKË

**Rezultatet e pritshme për këtë kapitull**

Në fund të këtij kapitulli mësimdhënësit do të jenë në gjendje:

- Të identifikojnë së paku tri aspekte të rëndësishme të KKK-së;
- Të demonstrojnë me shembuj konkretë si kontribuon fusha Artet në arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar;
- Të identifikojnë organizimin formal të arsimit parauniversitar (sistemin, nivelet, shkallët dhe fushat kurrikulare).

**Çka është KKK?**

Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK) është dokument me të cilën rregullohet gjithë arsimi parauniversitar. Në të përcaktohen qëllimet, parimet, nivelet formale të arsimit parauniversitar, fushat e kurrikulës, plani mësimor, metodologjia dhe format vlerësimit. Në figurë janë përfshirë të gjitha aspektet e mundshme të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës.




**Aktivitet**: Reflekto! Identifiko çështje kryesore që kanë të bëjnë me KKK-në, bisedon për to me kolegët tuaj.

| |
|---|
| Çfarë keni ditur për KKK-në?<br>Çfarë mësuam të re për KKK-në? |

Në figurën e mëposhtme janë dhënë nivelet, shkallët dhe dokumentet relevante që ndihmojnë zbatimin e KKK-së, respektivisht Kurrikulat Bërthamë (KB) për të tri nivelet formale të arsimit parauniversitar.

| KURRIKULA BËRTHAMË PËR KLASËN PARAFILLORE DHE ARSIMIN FILLOR TË KOSOVËS | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit - SNKA | Nivelet formale të arsimit parauniversitar në Kosovë | Shkallët e Kurrikulës | | Kurrikulat bërthamë |
| SNKA3 | Arsimi i mesëm i lartë (klasat X-XII) | Klasa XII | Shkalla e Kurrikulës 6: Konsolidim dhe specializim | Kurrikula Bërthamë për klasat X-XII të arsimit të mesëm të lartë |
| | | Klasat X-XI | Shkalla e Kurrikulës 5: Zhvillim i përgjithshëm themelor dhe profesional | |
| SNKA 2 | Arsimi i mesëm i ulët (klasat VI-IX) | Klasat VIII-IX | Shkalla e Kurrikulës 4: Përforcim dhe orientim | Kurrikula Bërthamë për klasat VI-IX të arsimit të mesëm të ulët |
| | | Klasat VI-VII | Shkalla e Kurrikulës 3: Zhvillim i mëtejmë dhe orientim | |
| SNKA 1 | Arsimi fillor (Klasat I-V) | Arsimi fillor Klasat III-V | Shkalla e Kurrikulës 2: Përforcim dhe zhvillim | Kurrikula Bërthamë për klasën parafillore dhe klasat I-V të arsimit fillor |
| | | Arsimi fillor Klasat I-II | Shkalla e Kurrikulës 1 Përvetësim themelor | |
| | | Klasa parafillore | | |
| SNKA 0 | Arsimi (Edukimi) parashkollor | Mosha 0-5 | Shkalla përgatitore e Kurrikulës: Edukimi në fëmijërinë e hershme | Kurrikula Bërthamë e edukimit parashkollor |

Aktivitet: Analizo me kolegë nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, shkallët kurrikulare që korrespondojnë me secilin nivel dhe karakteristikat e shkallës. Bisedoni specifikat e shkallës përkatëse kurrikulare në kontekst të fushës Artet. Çka e përcakton nivelin e arritjes së paraqitur në shkallë në kuptim të temave, njësive dhe veprimtarive artistike që duhet zhvilluar në klasët e shkallëve përkatëse? Krahasoni çfarë dallon nga programet ekzistuese? Shih në tri dokumentet e KB-ve nivelet formale të arsimit parauniversitar.

## II.1 Qëllimet e arsimit parauniversitar

| ***Qëllimet e arsimit parauniversitar sipas KKK-së (Kornizës së Kurrikulës së Kosovës)*** |
|---|
| • *Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore;*<br>• *Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare;*<br>• *Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;*<br>• *Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;*<br>• *Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë;*<br>• *Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.* |

Qëllimet e arsimit parauniversitar të paraqitura në KKK janë pjesë përbërëse e dokumenteve të Kurrikulave Bërthamë të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar. E gjithë përmbajtja e këtyre dokumenteve është në funksion të arritshmërisë së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë që edhe rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare – kompetenca (RNSH) dhe rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF) të secilës shkallë kurrikulare janë në funksion të arritjes së qëllimeve të arsimit parauniversitar. Edhe e gjithë puna praktike edukativo-arsimore që zhvillohet në shkollë duhet të jetë në funksion të arritshmërisë së këtyre qëllimeve. Qasjet e arritjes së qëllimeve duhet t'u përshtaten moshës dhe mundësive të nxënësve të secilit nivel formal, përkatësisht secilës klasë. Kjo do të thotë që edhe fusha kurrikulare e Arit, me gjithë tërësinë e vet, duhet të jetë kontribuues në arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar.

### Si arrihen qëllimet e përcaktuara në KKK?

Qëllimet e arsimit parauniversitar arrihen kur ato bëhen pjesë e planifikimeve mësimore të secilës klasë (planifikimeve vjetore, mujore, javore, orës mësimore) dhe e procesit mësimor që zhvillohet në klasë dhe jashtë saj. Me këtë rast mësimdhënësi i artit duhet të kalojë nëpër këto aktivitete:

- Të përzgjedhë rezultatet e të nxënit për shkallë - kompetencë (RNSH) që synohen të arrihen nga nxënësit gjatë periudhave të caktuara, përmes përmbajtjeve (temave dhe njësive mësimore) dhe aktiviteteve brenda dhe jashtë orës mësimore;
- Të përzgjedhë rezultatet e fushës kurrikulare apo lëndëve mësimore të arteve të secilës klasë nga planet dhe programet ekzistuese që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të arteve që janë në KB;
- Të përzgjedhë përmbajtjen mësimore (temat apo njësitë mësimore);
- Të përzgjedhë metodologjitë e mësimdhënies;
- Të përzgjedhë materialet dhe burimet mësimore;
- Të përzgjedhë e metodologjitë, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit
- Të përzgjedhë format e komunikimit;
- Të krijojë klimë në klasë dhe shkollë në favor të arritjes së qëllimeve.

Kultura, si një veprimtari më e gjerë, përveç formave të tjera, përfshin edhe artin popullor dhe artin e krijuar dhe manifestohet përmes elementeve nga trashëgimia kulturore kombëtare, sjelljet, mënyra e jetesës, sistemi i vlerave shoqërore në kontekstin historik dhe në ndërveprim me kulturat e

popujve të tjerë në rajon dhe më gjerë. Andaj në radhë të parë fusha e kurrikulës Artet kontribuon në mënyrë më të drejtpërdrejtë në arritjen e qëllimit të parë të arsimit parauniversitar, kultivimi i identitetit personal, kombëtar, përkatësisë shtetërore dhe kulturore, por edhe në arritjen e qëllimeve të tjera, sepse artet mundësojnë zhvillimin personal, intelektual dhe social të nxënësve, duke inkurajuar edhe kreativitetin, imagjinatën, socializmin, përgjegjësinë, aftësinë për të nxënë, e sidomos duke inkurajuar dhe zhvilluar aftësitë shprehëse artistike.

Shembull i kontributit të fushës kurrikulare ARTET në arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar
**Shkalla I - Fusha Artet-RNF. Shkalla I**
"*Nxënësi/sja demonstron aftësi për të përdorur mjetet e ndryshme shprehëse të arteve, (zërin, instrumentet, ngjyrat, format, fjalët, lëvizjen etj.), për të komunikuar dhe për të shprehur përjetimet dhe idetë e veta*" (KB për klasat parafillore dhe arsimin fillor, f. 45).
Klasa I, RNF 3.2: Nxënësi "shpreh përjetimet personale përmes lojës ku ka këndim, vallëzim, dramatizim, pantomim, modelim, ngjyrosje etj.).
Ky rezultat adreson këto rezultate të kompetencave: I.8, II.5, II.7, III.1, III.4, III.5, III.6, IV.1, IV.4 dhe IV.6.

Tema mësimore **Unë dhe familja**, Njësia mësimore **Familja ime e ngushtë** (klasa I).
Rezultati i të nx. arrihet përmes aktiviteteve të ndryshme në kuadër të fushës dhe lëndëve. P.sh: nx. këndon këngë për nënën, babanë, motrën ose vëllain; nx. vizaton dhe/ose modelon me materiale të ndryshme anëtarët e familjes; nx. shprehet për vete (dëshirat e veta, (me vizatim, fjalë, këngë, lëvizje etj), për familjen ( krijon album, punime, vjersha, ese, këngë); përdor këngë e valle popullore që i dëgjon në familje, etj. Shprehet për karakteristikat e anëtarëve të familjes me fjalë, vizatim, album, poster etj.

Me këto aktivitete të llojllojshme kontribuohet në arritjen e qëllimit të parë të arsimit parauniversitar:"**kultivimi i identitetit personal**, kombëtar, përkatësisë shtetërore, kulturore etj."…sepse me këtë temë konkrete mësimore arrihet në mënyrë të drejtpërdrejtë pjesa mbi identitetin personal. Me tema të tjera në vazhdimësi ( p.sh. Unë dhe familja e gjerë, Mjedisi im, Vendi im etj.) arrihen edhe pjesët tjera të këtij qëllimi. Drejt arritjes së qëllimeve duhet synuar në secilën klasë të arsimit parauniversitar.

Megjithatë nxënësit jo vetëm që zhvillojnë aftësinë për t'u shprehur dhe për të komunikuar në mënyrë efektive, por ata arrijnë ose adresojnë edhe qëllimet e tjera arsimore. P.sh. duke kënduar ose vizatuar, vallëzuar e aktruar bashkë ata zhvillojnë vëmendjen, përgjegjësinë për detyrën, punën e përbashkët, socializmin, por në të njëjtën kohë promovojnë vlerat kulturore të familjes, kombit, vendit etj. Kështu kontribuojnë përnjëherësh në arritjen e më shumë qëllimeve njëkohësisht, ku më pak e ku më shumë.

**Aktivitet:**
Me kolegë të lëndëve mësimore brenda fushës së Artit dhe shkallëve kurrikulare analizoni ndonjë rezultat tjetër të fushës kurrikulare nëpër shkallë dhe mundohuni të bëni ndërlidhjen në mes të RNF-së, RNSH-kompetencave dhe qëllimeve të arsimit parauniversitar, duke përzgjedhur ndonjë temë, nëntemë apo njësi mësimore konkrete të lëndës përkatëse me të cilën do të adresohet arritja e tyre. Diskutoni në fund se, përpos qëllimit primar, cilat qëllime të tjera i arrijnë tema dhe njësia e caktuar.
Burime dhe referenca ju i keni KKK-në, KB-të, planet dhe programet ekzistuese të lëndëve mësimore të arteve.

## II.2 Parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore në kontekstin e fushës kurrikulare Artet

| *Parimet e KKK-së* |
|---|
| • *Gjithëpërfshirja*<br>• *Zhvillimi i kompetencave*<br>• *Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent*<br>• *Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkollë*<br>• *Përgjegjësia dhe llogaridhënia* |

**Çka janë parimet e KKK-së?**

Parimet janë një lloj i rregullave, të cilat e mbështesin punën edukativo-arsimore për arritjen e qëllimeve të arsimit parauniversitar. Ato mbështesin edhe punën edukativo-arsimore të mësimdhënësve të secilës klasë dhe nivel arsimor. Ato janë udhërrëfyes të punës së suksesshme të mësimdhënësve që reflektohen në përgatitjen e nxënësve në çdo nivel për të tejkaluar sfidat në të nxënë dhe në zgjidhje të problemeve në raport me potencialet e tyre e në përgatitjen për të nxënë të mëtutjeshëm.

**Si mund të jemi në linjë të parimeve?**

Në linjë të **parimit të gjithëpërfshirjes** jemi atëherë kur:

- Kemi **planifikuar** duke diagnostikuar përvojat, dijet, kulturat, stilet e të nxënit të nxënësit-es dhe kem përmirësuar mësimdhënien;
- Kemi planifikuar duke synuar;
- Kemi përdorur **llojllojshmëri të metodave, teknikave dhe materiale** të ndryshme të mësimdhënies dhe të të nxënit, detyra të diferencuara për realizim të aktivitetit.

Dhe, nxënësi-sja:

- o Ndihet i pranuar në klasë nga nxënësit-set, edhe nga mësimdhënësi-sja njëjtë si të gjithë nxënësit pa dallim, qoftë të potencialit, qoftë gjinisë, përkatësisë fetare, përkatësisë sociale, ekonomike, shëndetësore, etnike dhe kulturore;
- o Ndihet i-e respektuar sa i përket, dinjitetit, përvojës, dijeve, stileve të të nxënit dhe mënyrës së të shprehurit dhe mendimit.

***Sepse kemi krijuar klimë ku secili-la ndihet rehat, i-e çmuar, kontribuues-se dhe i-e suksesshëm-e***

Në linjë të **parimit të zhvillimit të kompetencave** jemi atëherë kur:

- Kemi **planifikuar** duke pasur parasysh rezultatet e të nxënit të shkallës-kompetencës (RNSH), rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (RNF) të arteve të shkallës përkatëse kurrikulare, apo të lëndës për klasë të caktuara (p.sh klasa e parë, e gjashtë, Edukatë

muzikore ose figurative, klasa e dhjetë Art figurativ ose muzikor) të marra dhe të adaptuara nga planet dhe programet ekzistuese që janë në përdorim.

- Kemi aplikuar **metodologji** dhe **mjete** didaktike, të cilat kanë nxitur dëshirë, kreativitet dhe pavarësi sipas interesave, dispozitave krijuese dhe performuese të nxënësve;
- Kemi përdorur **teknika** dhe **instrumente** të **vlerësimit,** të cilat kanë ndihmuar vetëvlerësimin, identifikimin e saktë të shkallës së arritshmërisë dhe pastaj kem marrë masa për përmirësim.

**Dhe,** nxënësi-sja:

- Zhvillon kompetencat **Komunikues efektiv** që adresohen në mënyrë më të drejtëpërdrejtë me këtë fushë, duke adresuar rezultatet e të nxënit të fushës Artet apo lëndëve për klasët përkatëse dhe duke zhvilluar aftësitë konkrete artistike. Kështu bëhet **Nxënës i suksesshëm,** por edhe **Mendimtar kreativ**, sepse ai demonstron shkathtësi të mendimit kreativ gjatë realizimit të idesë krijuese, performancës, shprehjes artistike në kuadër të aktivitetit.
- Njëkohësisht nxënësi edhe zhvillon aftësi për të menaxhuar kohën, mjetet, teknikat dhe proceset krijuese për shfrytëzimin e burimeve të duhura për finalizimin e detyrës/(performancës, krijimit), por edhe menaxhon emocionet e veta, nuk është arrogant-e, konfliktuoz-e, i-e tensionuar,… **Individ i shëndoshë**;
- Demonstron aftësi për të krijuar edhe në mënyrë të pavarur, por edhe kur punon në grup (p.sh. modelimi, vizatimi si punë individuale, këndimi individual dhe ne grup, vallëzimi, aktrimi (vetë dhe në grup) dhe aktivitetet e tjera artistike individuale ose grupore), demonstron tolerancë, mirësjellje, solidaritet-përkrahje, respekt dhe përgjegjësi ndaj vetes, të tjerëve dhe mjedisit; **Qytetar i përgjegjshëm;**
- Demonstron qëndrim pozitiv për sjellje, ngjarje a dukuri, p.sh qëndrim pozitiv ndaj artit popullor, trashëgimisë kulturore etj. duke marrë pjesë në aktivitete artistike dhe kështu bëhet **Kontribuues produktiv.**

***Dhe, kështu zhvillojmë nxënës-e kompetent-e***

**Në linjë të parimit të mësimdhënies së integruar dhe të të nxënit koherent** jemi atëherë kur:

- Kemi **planifikuar** lidhje ndërlëndore brenda fushës së njëjtë, përmes përzgjedhjes së **temave** të **përbashkëta;**
- Kemi **planifikuar lidhje në mes të fushave** kurrikulare ashtu që ndihmojmë zhvillimin e gjuhës te shkencat, Artet, Jeta dhe puna, por edhe te Matematika; apo ndihmojmë zhvillimin e temave të shkencave, shoqërisë dhe mjedisit, si përmes Matematikës, Gjuhës dhe Arteve (p.sh. vjeshta, tema-njësia mësimore e shkencave ndihmohet të realizohet përmes esesë në gjuhë, por edhe përmes artit e muzikës; (punim me temë “Vjeshta”, këngë “Vjeshta”, vepër muzikore për dëgjim etj;
- Kemi **planifikuar module** dhe **projekte**, ku gjenden elemente të shumë fushave kurrikulare, p.sh. projekti Realizimi i shfaqjes /programit për “Ditën e Flamurit” përfshin gjuhën, historinë, artet, gjeografinë etj.

**Dhe,** nxënësi-sja:

- Analizon një detyrë, situatë, ngjarje a dukuri nga kënde të ndryshme (p.sh. një temë konkrete -Vendi im, mund të trajtohet edhe në gjuhë, në histori, gjeografi, në arte, edukatë qytetare, por edhe në matematikë (me shifra, përqindje) etj., biologji (flora dhe fauna) etj;

- Identifikon ndërlidhjen dhe ndërvarësinë e detyrave, ngjarjeve dhe dukurive (p.sh. dallimin dhe identifikimin e ngjyrave bazike dhe atyre që krijohen me kombinime, konceptet muzikore tingull, ritëm e melodi dhe ndërlidhjen e tyre: melodia është tërësia e disa tingujve të organizuar sipas një ritmi të caktuar etj.

***Dhe, kështu zhvillojmë të nxënë gjithëpërfshirës dhe koherent***

Në linjë të **parimit të autonomisë dhe fleksibilitetit** jemi atëherë kur:

- Kemi përgatitur **plan mësimor** (shpërndarje të orëve mësimore për fusha kurrikulare dhe lëndë mësimore) dhe **planifikime mësimore** (vjetore, mujore ditore) konform rezultateve të të nxënit për shkallë (kompetenë), rezultateve të të nxënit për fushë kurrikulare për shkallë dhe rezultateve të të nxënit për fushë kurrikulare a lëndë mësimore për klasë dhe ia përshtatim këto përvojave, ritmeve e stileve të të nxënit të nxënësve dhe kontekstit specifik të lokalitetit, shkollës dhe përbërjes së klasës.
- Kemi hartuar **kurrikulë zgjedhore** konform talentit, afiniteteve dhe interesave të nxënësve.

**Dhe,** nxënësi-sja

- Përparon dijet dhe shkathtësitë në bazë të ritmit individual të të nxënit;
- Aplikon stilin individual të të nxënit;
- Zhvillon talentet e ndryshme mbi bazën e afiniteteve, predispozitave dhe interesave.

***Dhe, kështu zhvillojmë nxënës-e të suksesshëm-e***

Në linjë të **parimit të përgjegjësisë dhe llogaridhënës** jemi atëherë kur:

- Jemi transparentë për saktësinë dhe nivelin e arritjes së kompetencave dhe rezultateve për secilën detyrë, përfshijmë aktivitet me secilin nxënës-e dhe kemi diskutuar rrugët e arritjes së rezultateve, por edhe të mënyrës së matjes dhe vlerësimit;
- Jemi transparentë dhe në komunikim të vazhdueshëm me prindër për të arriturat e rezultateve të kompetencave dhe rezultateve të fushës kurrikulare, lëndës apo temës mësimore;
- Jemi transparentë me Këshillin e klasës e të shkollës për nivelin e arritjes së rezultateve të kompetencave, të fushës, lëndës ose temës për paralelet të cilat i udhëheqim.

**Dhe:**

- Nxënësi-sja është në dijeni për nivelin e arritjes së vetë konform kërkesave të shtruara nga mësmdhënësi-ja;
- Prindërit janë në dijeni për nivelin e arritjes së fëmijëve të tyre konform rezultateve të nxënit të shkallës (kompetencës) rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare për shkallë, rezultateve të të nxënit të lëndës a temës mësimore për klasë;
- Këshilli i klasës, Këshilli i shkollës janë në dijeni për nivelin e arritjes së nxënësve të paraleles.

***Dhe, kështu përmirësojmë mësimdhënien dhe rrisim të nxënit e nxënësve***

**AKTIVITET**: Diskutoni me kolegët e fushës se si mund të zbatohen/respektohen parimet në kuadër të lëndëve të fushës së Artit. Merrni shembuj nga lëndët mësimore të arteve. Shembull:

**Lënda:________________________**

**Klasa:________________________**

**Tema:__________________ Njësia mësimore ____________ RNSH_________ RNF______**

**Parimet që respektohen gjatë procesit të përgatitjes dhe realizimit:**

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

______________________________________________________________________________

## II.3 Kuptimi dhe funksioni i rezultateve të të nxënit

**Rezultatet e pritshme për këtë nënkapitull**

Në fund të këtij nënkapitulli mësimdhënësit do të jenë në gjendje:

- Të identifikojnë kompetencat të cilat adresohen nga fusha Artet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kompetencat e tjera në të cilat kontributi i fushës Artet ndikon në mënyra të tjera;
- Të identifikojnë teknikat /mënyrat si të planifikohet mësimi i orientuar nga kompetencat të shprehura përmes rezultateve të të nxënit në shkallë dhe fushë;
- Të dallojnë rezultatet e të nxënit për shkallë (RNSH)-kompetenca nga rezultatet e të nxënit për fushë (RNF);
- Të hartojnë rezultatet e të nxënit për lëndë (RNL) për klasë të caktuar.

### II.3.1 Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca (RNSH)

| **Kompetencat** |
| --- |
| • Komunikues efektiv<br>• Mendimtar kreativ<br>• Nxënës i suksesshëm<br>• Kontribuues produktiv<br>• Individ i shëndoshë<br>• Qytetar i përgjegjshëm |

**Çfarë janë kompetencat?**

Kompetencat janë tërësi e njohurive, shkathtësive, shprehive, sjelljeve dhe qëndrimeve e vlerave që nxënësit i arrijnë në fund të arsimit parauniversitar si rezultat i qëllimeve, respektimit të parimeve dhe përzgjedhjes së përmbajtjeve e strategjive mësimore dhe për vlerësimet që përdoren në funksion të zhvillimit të këtyre kompetencave. Realizimi i qëllimeve të KKK-së bëhet kur në mënyrë të integruar bashkëveprojnë të gjitha elementet si në figurë:

# Korniza e Kurrikulës (KKK) e Arsimit Parauniversitar të Kosovës

**QËLLIMET KOMPETENCAT PARIMET**

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Qëllimet e arsimit parauniversitar* | Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore | Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare | Zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit | Aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore | Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë | Aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Kompetencat e nxënësve* | Komunikues efektiv | Mendimtar kreativ | Nxënës i suksesshëm | Kontribues produktiv | Individ i shëndoshë | Qytetarë i përgjegjshëm |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *Parimet e kurrikulës* | Gjithpërfshirja | Zhvillimi i kompetencave | Mësimdhënie dhe të nxënit e integruar dhe koherent | Autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle | Përgjegjësia dhe llogaridhënia |

**REALIZIMI NË SHKOLLË**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Fushat e kurrikulës* | Gjuhët dhe komunikimi | Artet | Matematika | Shkencat natyrore | Shoqëria dhe mjedisi | Shëndeti dhe mirëqenia | Jeta dhe puna |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mësimdhënia dhe të nxënit* | Qasje të ndryshme në klasë | Bazuar në njohuritë paraprake | Klasa gjithëpërfshirëse | Ndërlidhje e teorisë me praktikë | Pjesëmarrje aktive | Me nxënës në qendër | Puna me teknologji të re |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Çështjet ndërkurrikulare* | Paqa dhe toleranca | Edukim shëndetësor dhe seksual | Barazia | Vetëdijesim për ekonomi | Mësim në distancë | Përgatitja për jetë dhe punë | Edukim për ndërmarrësi | Shkathtësitë komunikuese në fusha kurrikulare |

**VLERËSIMI**

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Vlerësimi i të arriturave* | Integruar në mësimdhënie dhe të nxënë | Bashkë me nxënës | Përdorë të dhëna nga burime të ndryshme | Për çdo ditë, i rastit, në fund të një teme/njësie mësimore | Promovon kurrikulë të gjerë dhe të balancuar | Mirëkuptohet nga nxënësit | Ndihmon progresin e nxënësve | Ofron informata kthyese | Ndihmon të identifikuarit e fushave për ndërhyrje | Përdorë vlerësim nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| *Masat për llogaridhënie* | Të arriturat | Sjelljet | Pjesëmarrja si qytetar | Kujdesi për shëndet | Punësueshmëria | Përfshirja në edukim të mëtejmë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| *Mjetet dhe procedurat për vlerësim* | Vlerësim i brendshëm | Vlerësim në nivel klase | Vlerësim në nivel shkolle | Vlerësimi i jashtëm | Provimi i maturës |

Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
dhe i implementuar nga Cambridge Education, Qendra për Arsim e Kosovës, Education 2000+ Consulting dhe Tribal Helm

**Si punojmë për arritjen e rezultateve për shkallë kurrikulare - kompetencave?**

Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare - kompetenca (RNSH) janë të specifikuara për çdo shkallë kurrikulare. Ato janë formuluar si kërkesa apo rezultate konkrete e të matshme që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në fund të secilës nga këto shkallë. Ato mund të jenë njohuri, shkathtësi, por edhe qëndrime, vlera dhe rutina/shprehi mësimore, të cilat duhet zhvilluar te secili nxënës-e përgjatë klasave të shkallës kurrikulare.

Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht arritshmëria e rezultateve të shkallës - kompetencave bëhet përmes fushave kurrikulare. Të gjitha fushat kurrikulare apo lëndët mësimore që mbahen në shkallën e caktuar kurrikulare, apo në klasat e caktuara brenda shkallës kurrikulare, kontribuojnë bashkërisht në arritjen e rezultateve të të nxënit të shkallës-kompetencave (shih KB-të, rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetencave për shkallët përkatëse kurrikulare).

Nuk do të thotë që fusha kurrikulare Artet si e vetme i arrin të gjitha rezultatet e të gjitha kompetencave. Secila fushë kurrikulare duhet fiksojë rezultatet e të nxënit për kompetencë që do të synojë t'i arrijë për secilën klasë. Mund të ndodhë që disa rezultate të njëjta të kompetencave të jenë pika synuese për disa fusha kurrikulare, por mund të ndodhë që disa të përzgjidhen nga një fushë e vetme. **Por kujdes!** *Të gjitha rezultatet e kompetencave duhet të arrihen deri në fund të shkallës së caktuar dhe gjithsesi duhet të koordinoheni me fushat e tjera kurrikulare.*

P.sh. rezultati IV.2 (KB shkalla e parë, f. 21), nxënësi-sja "*Kontrollon mjetet/materialet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo jashtë saj)*" është rezultat që arrihet përmes të gjitha fushave kurrikulare, por ka rezultate të të nxënit që arrihen nga fusha e caktuar.

Ose p.sh. rezultati I.7 Shkalla 1, f. 20, "*përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve*", është rezultat që mund të arrihet drejtpërdrejt përmes arteve, por edhe përmes gjuhës dhe komunikimit, por edhe përmes fushave të tjera kurrikulare;

*P.sh përmes artit figurativ shpreh përshtypjet, imagjinatën për mjedisin (tema të veçanta ose në mënyrë të lirë)...po ashtu përmes artit muzikor i këndon natyrës, lumenjve, detit, etj... e edhe dëgjon vepra muzikore me temë përshkruese për natyrën, e në nivelin më të lartë përzgjedh muzikën e veçantë për të asociiuar me ndonjë nga dukuritë natyrore, llojin e ambientit etj.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencë mund të jenë të synuara në çdo klasë sa ka shkalla, por arritshmëria e tyre duhet të bëhet konform moshës dhe mundësive të nxënësve. P.sh. rezultati i mësipërm duhet të synohet në të tri klasat e shkallës së parë, por arritshmëria e plotë e tyre duhet të arrihet deri në fund të klasës së dytë.

P.sh., rezultati I.7, shkalla e parë, "*përshkruan në forma të ndryshme shprehëse mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe atë e prezanton para të tjerëve*", ky rezultat në klasën parafillore arrihet kur nxënësi-ja përshkruan

ndonjë ngjarje natyrore apo shoqërore, me forma më të thjeshta, vija, shkarravitje, ngjyra, këngë për ndonjë ngjarje natyrore ose shoqërore që është më e lehtë, bile edhe me përshkrim me gojë ose shkrim me fjalorth më të varfër (disa fjalë ose një apo dy fjali). Pastaj në klasë të parë dhe të dytë ky rezultat arrihet duke u thelluar dhe avancuar "të shprehurit", p.sh. zgjeron fjalorin (përdor disa fjali), kombinon në mënyrë më të pasur vijat, ngjyrat dhe në mënyrë me domethënëse këngët janë më të avancuara, kombinohen materialet dhe teknikat shprehëse etj. **Arritshmëria e plotë e këtij rezultati duhet të arrihet deri në fund të klasës së dytë.**

P.sh. Kompetenca kontribuues produktiv IV.7, (shkalla III, kl VI dhe VII,KB f. 21) " *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik, etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/ aktiviteti në bazë klase/ shkolle apo jashtë saj."* Ky rezultat i kompetencës (RNSH) mund të arrihet në mënyra të ndryshme, në kontekst të fushës Artet, por edhe në fushat e tjera mësimore, varësisht se cila temë zgjidhet.

Në kuadër të fushës Artet një aktivitet i përbashkët mund të jetë edhe një këngë ose pjesë instrumentale, të cilat ata i realizojnë brenda klasës ose në program shkollor. Mund të jetë një projekt në kuadër të lëndës Edukatë figurative (SNKA1dhe SNKA2)/Art figurativ (SNKA3) (një maketë, një mozaik i përbashkët në tema të ndryshme, një ekspozitë, por edhe një poster i përbashkët, i cili mund të jetë me temë edhe nga fushat tjera. P.sh. poster për avokim për mbrojtjen e ambientit, poster për organizmat e gjallë dhe sistemimin e tyre...ose sistemin e instrumenteve muzikore brenda një familje instrumentesh etj.

Ja një shembull posterësh krijuar në klasën VI, Edukatë muzikore krijuar nga nxënësit e shkollës 'F. Konica':






**Përpos që nxënësit i kanë përforcuar njohuritë për kompozitorin Moxart (fig. 1) dhe muzikën popullore (fig .2), në grup e kanë punuar posterin për të pasuruar ambientin e klasës dhe për të shërbyer edhe për nxënësit tjerë si mjet konkretizimi. Kështu edhe është adresuar ky rezultat i kompetencës Kontribuues produktiv, ndërlidhja në mes artit muzikor dhe artit figurativ, por edhe brenda vetë artit figurativ, është trajtuar teknika e posterit, arti aplikativ, kompozicioni dhe përdorimi i materialeve të ndryshme.**

Në mënyrë që rezultatet e të nxënit për kompetencë të jenë të arritshme ato duhet të jenë prezente pothuajse në të gjitha planifikimet mësimore të secilës fushë kurrikulare.

Aktivitet 1: Diskutoni me kolegët tuaj, cilat rezultate të të nxënit të kompetencave të tjera mund të adresohen përmes këtyre dy mini-projekteve. Arsyetojeni zgjedhjen tuaj!

Aktivitet 2: Diskutoni me kolegët tuaj, në lëndë sipas niveleve përkatëse (klasat I, VI dhe X) çfarë do të mund të ishte një projekt tjetër i përbashkët për të adresuar këtë kompetencë?!

## II.3.2 Rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF) dhe ndërlidhja e tyre me përmbajtjen mësimore ( temat/nëntemat dhe njësitë mësimore)

Rezultatet e të nxënit të fushave kurrikulare (RNF) janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme të fushës përkatëse dhe janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore, përkatësisht në përzgjedhjen e temave mësimore.

***Konceptet*** *janë shtylla përmbajtjesore rreth së cilave organizohet e gjithë përmbajtja mësimore e fushës kurrikulare brenda shkallës kurrikulare, e në këtë rast edhe të fushës së Arteve. Ato janë prezente në klasat e shkallës kurrikulare. Fuqia e prezencës së tyre në periudha të ndryshme kohore brenda një viti shkollor të një klase të caktuar, por edhe të klasave të ndryshme të shkallës së njëjtë, mund të jetë e larmishme.*

**Si e përzgjedhim përmbajtjen nga RNF?**

Me rastin e përzgjedhjes se rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare të Arteve, të cilat do t'i synojmë t'i arrijmë me nxënës në klasë të caktuara, së pari duhet identifikuar konceptet e fushës kurrikulare nga të cilat dalin rezultatet e caktuara. Shih **shembullin** e ndërlidhjes së rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare (RNF) me konceptet e fushës kurrikulare, shkalla 4 e kurrikulës, KB f. 39 dhe 43.

Duhet të sqarojmë fillimisht se konceptet mësimore që trajtohen nga fusha Artet janë specifike vetëm për këtë fushë, e bile mund të jenë specifike për lëndën e caktuar (p.sh tingulli në Edukatën muzikore, hapësira në Edukatën figurative), por mund të ketë edhe koncepte të përbashkëta që shtjellohen në mënyrë të ndryshme nga lënda e caktuar: (p.sh. forma - si koncept trajtohet edhe në muzikë, edhe në art figurativ, edhe në vallëzim; lëvizja, ngjyra, drejtpeshimi, harmonia etj... janë disa koncepte të tjera të përbashkëta. Por, këto kanë kuptim të ndryshëm brenda lëndës së caktuar. P.sh. veprat muzikore kanë formë, por edhe në veprat figurative ( pikturë, skulpturë, etj. forma është thelbësore). Ose p.sh. koncepti i ritmit ekziston edhe në muzikë, edhe në art figurativ, edhe në dramë edhe në vallëzim..., por ka kuptim të ndryshëm, p.sh. ritmi në muzikë është element ndërtimi i melodisë, këngës, (nuk ka melodi pa ritëm)... në art figurativ trajtohet ritmi i përsëritjes së motiveve, ngjyrave, etj., në dramë trajtohet ritmi i dialogut, shfaqjes, kurse në vallëzim ritmi i lëvizjes (në baza të muzikës). Megjithatë, ndonëse ka koncepte që i takojnë fushës Artet, ka edhe koncepte që i takojnë në mënyrë të veçantë vetëm ndonjërës nga lëndët e kësaj fushe: p.sh. kënga në muzikë, peizazhi në art figurativ, monologu në dramë, pirueta në vallëzim etj.

Ja një shembull si mund të trajtohet koncepti i përbashkët i fushës në mënyra të ndryshme nga lëndët mësimore të fushës Artet:

| Koncepti i fushës<br><br>Artet (shih konceptet kryesore që mësohen përmes arteve) | Qëllimi i konceptit | RNF (shkalla 4) |
|---|---|---|
| **FORMA** | Të njihet forma si koncept artistik;<br><br>Të kuptohet/dallohet forma si element i ndërtimit të veprës artistikeë<br><br>Të aftësohet nxënësi në mënyrë të pavarur që ta përdorë aplikojë formën në veprën/punimin e tij. | RNF 2: Njeh dhe kupton* përdorimin e mjeteve te ndryshme shprehëse artistike për realizimin e veprave artistike te formave, gjinive, zhanreve e stileve të ndryshme artistike, p.sh:<br><br>2.1. kupton* mënyrën e ndërtimit të formës së veprave muzikore në stile të ndryshme (fuga, sonata etj. ) e në zhanre të ndryshme (këngë popullore, muzike e lehtë, rok, pop, jazz etj. );<br><br>2.2. kupton *mënyrat e ndryshme për modelim, skulpturim. |

Sqarim: *Në tabelë po vëreni se është përdorur folja *kupton,* ndonëse e dimë se duhet përdorur vetëm folje vepruese për të shprehur rezultatet e të nxënit, por kur është fjala pikërisht te koncepti – FORMA, nxënësit me të vërtetë do ta kuptojnë se si një vepër muzikore nuk mund të ekzistojë pa formë (2.1) dhe po ashtu në pikturë, ose sidomos skulpturë dhë vepra kur përdoret teknika e modelimit, forma ka shumë rëndësi (2.2.)..., por të kuptuarit e formës nga ana e nxënësit ne do ta matim përmes dallimit të formave të ndryshme në vepra të ndryshme.

Ndodh që disa koncepte të fushës kurrikulare të jenë prezente në një rezultat të fushës kurrikulare, por sidoqoftë njëra nga to - konceptet, ndihet më fuqishëm.

Konceptet e fushës kurrikulare, së bashku me rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare, na ndihmojnë në përzgjedhjen e përmbajtjes mësimore (temave mësimore) për fushën kurrikulare për secilën klasë sa ka shkalla kurrikulare. Shih **shembullin** e hapat që duhet ndjekur deri te definimi i temës mësimore të fushës kurrikulare.

***Temat** mësimore janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimorë brenda një fushe kurrikulare gjatë periudhave të caktuara kohore të një viti shkollor.*

| Hapi 1 | hapi 2 | hapi 3 |
|---|---|---|
| **Konceptet** | **RNF** | **Tema mësimore** |
| **FORMA** | 2.1. kupton* mënyrën e ndërtimit të formës së veprave muzikore në stile të ndryshme (fuga, sonata etj. ) e në zhanre të ndryshme (këngë popullore, muzikë e lehtë, rok, pop, jazz etj.);<br><br>2.2. kupton *mënyrat e ndryshme për modelim, skulpturim. | Të përbashkët:<br>FORMA NË VEPRAT ARTISTIKE<br>**Edukatë muzikore-**<br>NJ: Format-në stilin homofonik (e këngës, formësonata, rondo, tema me variacione).<br>Format në stilin polifonin(kanoni, fuga)<br>NJ-FORMA DYPJESORE: E THJESHTË DHE E PËRBËRË NJ-FORMA TRIPJESORE-E THJESHTË DHE E PËRBËRË<br>NJ-FORMA E KËNGËS NË VEPRA MUZIKORE.<br>**Edukatë figurative**<br>T:FORMA<br>NJ-FORMA DYDIMENSIONALE<br>NJ-FORMA TREDIMENSIONALE<br>ETJ. |

Për shkak të karakteristikave të fushës së arteve, për dallim prej fushave të tjera, mund të ndodhë që shpesh konceptet të përdoren edhe si tema mësimore. Këtë e shihni në shembullin më lart, por do të hasni edhe në shembujt më poshtë.

Temat mësimore mund të jenë të vlefshme për të gjitha lëndët mësimore sa ka fusha kurrikulare dhe, duke pasur parasysh parimin mësimdhënies së integruar dhe koherente, mësimdhënia përmes temave të përbashkëta për të gjitha lëndët mësimore është në funksion të respektimit të këtij parimi. Por, në fushën e arteve, përpos që ka tema të përbashkëta që i mbulojnë lëndët e fushës së Arteve ka edhe tema dhe njësi mësimore të cilat janë specifike për secilën nga to, kujto lëndët Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore në SNKA1 dhe SNKA2 dhe Art figurativ dhe Art muzikor në SNKA 3. Gjithashtu, mund të ketë raste që nga disa rezultate të fushës kurrikulare të përcaktojmë përmbajtjen - temën mësimore vetëm për një lëndë mësimore. (lexo rezultatet e fushës se Artit në tri KB-të).

Ka edhe raste kur fusha artet kontribuon në realizimin e temave të tjera mësimore që trajtohen më detajisht nga fushat e tjera mësimore. Aty mund të vërehet ndërlidhja në mes të fushave kurrikulare, lëndëve mësimore dhe kjo më tepër ndodh në nivelin fillor, klasat 1-5.

*P.sh. tema "Unë dhe familja" mund të përdoret për të adresuar rezultatet e të nxënit si nga lënda Edukatë figurative ashtu edhe nga lënda Edukatë muzikore. Por ka edhe tema konkrete që adresohen vetëm përmes një lënde të caktuar mësimore. P.sh. mozaiku apo portreti si teknikë figurative mund të adresohen vetën nga Edukata figurative/Arti figurativ, kurse kohëzgjatja e tingujve muzikorë (masa kohore, ritmi, takti) , tonaliteti dur dhe mol et.j mund të adresohen vetëm përmes Edukatës muzikore/Art muzikor.*

**Aktiviteti 1:** Zgjidhni ndonjë rezultat të të nxënit të shkallës (RNSH) në një nga gjashtë kompetencat. Bisedoni në grup se cilat nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) kontribuojnë në arritjen e RNSH-së që keni zgjedhur. Po ashtu, bisedoni me çfarë teme apo temash mësimore do të mund të adresohej ai rezultat konkret. Diskutoni zgjidhjet tuaja me grupet e tjera.

**Aktiviteti 2:** Identifikoni rezultatet që mund të arrihen përmes dy lëndëve mësimore Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore. Gjithashtu, identifikoni ndonjë rezultat që mund të arrihet vetëm me njërën nga këto lëndë. (Shih rezultatet e fushës së Arteve në njërën nga KB-të).

## II.3.3 Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare, apo lëndës mësimore (RNL), brenda shkallës kurrikulare

Meqenëse rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare, e në këtë rast edhe për fushën e Arteve, në kurrikulat bërthamë për tri nivelet formale të arsimit parauniversitar, paraqiten për shkallë kurrikulare e jo për klasë dhe lëndë mësimore, atëherë konsiderohet si nevojë hartimi i rezultateve të të nxënit për klasë dhe lëndë mësimore, si për Edukatën figurative dhe për Edukatë muzikore në SNKA1 dhe SNKA 2 dhe Art figurativ dhe Art muzikor në SNKA 3. Hartimi i këtyre rezultateve siguron kohezionin dhe mosngarkesën e njërës klasë brenda një shkalle kurrikulare.

Rezultatet e të nxënit janë deklarata, të cilat duhet të hartohen në mënyrë të strukturuar. Struktura e rezultatit të të nxënit për lëndë përmban katër pjesë kryesore: Veprimi (V), Qëllimi (Q), Kushtet (K) dhe Kriteri (K).

**Shembull jo i drejtë i shkrimit të rezultatit.**
Nxënësi:

*- Të dijë (veprim/ose aktivitet) të modelojë një objekt (objekt) me plastelinë (kusht).*

**Shembull i drejtë i shkrimit të rezultatit.**

Nxënësi:

*- Modelon (veprimi ose aktiviteti) shkronjën A (qëllimi ose objekti) me plastelinë me ngjyrë të kuqe (kushti).*

*-Modelon (veprimi ose aktiviteti) saktësisht (kriteri). .shkronjën A (qëllimi ose objekti) me plastelinë me*

**Si hartohen rezultatet për klasë dhe lëndë mësimore?** Hartimi i rezultateve të të nxënit për klasat mund të bëhet nga vetë mësimdhënësit, por edhe të merren nga planet dhe programet ekzistuese. Nëse shfrytëzohen planet dhe programet ekzistuese, atëherë shkrimi i tyre bëhet duke i krahasuar rezultat e pritshme të lëndëve mësimore të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të Kurrikulës Bërthamë të nivelit, respektivisht të shkallës së caktuar, të cilës i përket klasa e caktuar. Në këtë rast bëhet përzgjedhja e rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese që janë në funksion të arritjes të secilit rezultat të të nxënit të fushës kurrikulare të Kurrikulës Bërthamë për shkallën e caktuar kurrikulare. Nëse rezultatet e pritshme të përzgjedhura nga planet dhe programet nuk përmbushin në tërësi rezultatin e caktuar të fushë kurrikulare, atëherë mund të shkruhen edhe rezultate të reja. Rezultat e fushës kurrikulare apo lëndës mësimore për klasë mësimore na ndihmojnë në përcaktimin e njësive mësimore të cilat janë në funksion të temës së përbashkët të fushës kurrikulare. Shih formatin e mundshëm të tabelës të hartimit të rezultateve për fushë apo lëndë mësimore në nivel klase. Ky format duhet të zhvillohet sipas hapave të dhënë në tabelë.

| **Krahasimi i rezultateve të pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese me rezultatet e fushës kurrikulare Artet të Kurrikulës Bërthamë (KB)<br>Shkalla 3 (klasat VI, VII)** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare Artet (RNF), marrë nga KB** | **Rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese të lëndëve mësimore që korrespondojnë me RNF** | | | **Rezultatet pritshme që duhet të shtohen në planet dhe programet e lëndëve mësimore** | | **Rezultatet e përpunuara përfundimtare që duhet të vendosen në planet dhe programet e lëndëve mësimore (RNL)** | |
| | **Lënda** | **Klasat** | | **Klasat** | | **Klasat** | |
| | | **Klasa VI** | **Klasa VII** | **Klasa VI** | **Klasa VII** | **Klasa VI** | **Klasa VII** |
| | **Edukatë figurative** | | | | | | |
| | **Edukatë muzikore** | | | | | | |

Për çështje praktike, rezultateve të fushës së kurrikulës (RNF), marrë nga Kurrikula Bërthamë, por edhe rezultateve të planeve dhe programeve ekzistuese, është mirë që t'u vendosen nga një numër rendor kur vendosen në këtë tabelë, në mënyrë që të dihet saktë se cilat rezultate korrespondojnë me njëra-tjetrën. Nëse njërit rezultat të fushës kurrikulare në nivel shkalle i keni vendosur numrin rendor 1, atëherë edhe rezultateve të planeve dhe programeve që korrespondojnë me këtë rezultat t'u vendosen numrat, p.sh. në këtë rast numri 1.

Pasi të keni shkruar rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore (RNL), atëherë mund bëni ndërlidhjen e tyre me rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare - kompetenca (RNSH). Shih shembullin më poshtë.

***Shembull** i ndërlidhjes së RNSH me RNF dhe RNL në klasën e gjashtë (shkalla e tretë)*

| Hapi 1 | hapi 2 | Hapi 3 |
|---|---|---|
| **RNSH (kompetenca)** | **RNF- Artet** | **RNL** |
| III 3-Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet. | **I.1 (shkalla 3) Demonstron përdorim të suksesshëm të mjeteve shprehëse, teknikave përkatëse të disiplinave artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim.** | Ed. Muzikore: I.1.1. Këndon dhe/ose interpreton ne instrumente muzikore,<br>Këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst<br>notal; |
| IV.4. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p. sh. pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohen etj.) për realizimin<br>e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet. | **RNF I.2. Krijon duke përdorur në mënyrë kreative dhe origjinale materialet, teknikat dhe mjetet shprehëse të arteve përkatëse.** | Ed: I.2.1 fig: vizaton, ngjyros, modelon (me laps, ngjyra, plasteline, letër<br>e materiale te tjera) ne mënyrë të lirshme dhe kreative ose në tema të caktuara. |
| II.3. Analizon një punim artistik ose joartistik (p. sh. , artikull gazetaresk, pikture. . . etj. ) duke gjetur analogji dhe dallime me punime te ngjashme nga autorë të ndryshëm. | RNF.2.2. Njeh dhe kupton përdorimin e mjeteve të ndryshme shprehëse<br>artistike për realizimin e veprave artistike te formave, gjinive, zhanreve e stileve të ndryshme artistike, p. sh. | Vallëzim: RNF I.2.3. Krijon koreografi origjinale sipas muzikës, tekstit ose situatës<br>së caktuar.<br><br>RNL Ed. Muzikore<br><br>Dallon formën e sonatës në vepra të ndryshme muzikore në stile të ndryshme.<br><br>RNL Edukatë figurative<br><br>Dallon teknikat e ndryshme të punimit të portretit në periudha të ndryshme stilistike. |

***MENDO!** Rezultatet e kompetencave janë të synuara, por jo domosdoshmërisht të arritura në klasën e gjashtë. Ato mund të synohen disa herë brenda vitit mësimor, por edhe në klasën e shtatë. D.m.th. synohen elementet e saj derisa në fund të shkallës arrihen plotësisht.*

Nga ajo që u përshkrua më lart lidhur me hierarkinë e ndërlidhjes së RNSH dhe RNF me nivelet e tjera të planifikimit që zhvillohen në nivel shkolle, prezantohet figura në vijim, e cila orienton mësimdhënësit dhe aktorët e tjerë në shkollë se si t'i qasen planifikimit mësimor dhe gjithashtu tregon se me arritjen e planifikimit mësimor në nivelin e caktuar si ndikojmë në arritjen e RNSH dhe RNF të vendosura në Kurrikulën Bërthamë.




**Aktiviteti 1**: Merrni ndonjë shembull konkret duke zbërthyer rezultatin e fushës kurrikulare të Arteve të ndonjë shkallë kurrikulare në rezultat të lëndës në nivel të klasës së caktuar të shkallës përkatëse.

**Aktiviteti 2:** Krahaso ndonjë rezultat të planeve dhe programeve ekzistuese të njërës nga lëndët e artit, si Muzikë apo Art figurativ me ato të fushës kurrikulare dhe mundohu ta plotësosh tabelën për nivelin përkatës, lëndën dhe klasën përkatëse.

<u>Për burime shfrytëzo Kurrikulën Bërthamë dhe planin e programin ekzistues për lëndën e caktuar.</u>

# III. ASPEKTET METODOLOGJIKE DHE PRAKTIKE TË PLANIFIKIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KURRIKULËS SË RE, FUSHA E KURRIKULËS ARTET

*Rezultatet e të nxënit: Në fund të këtij kapitulli, mësimdhënësit do të jenë në gjendje të:*

- Hartojnë planin mësimor;
- Hartojnë planin në nivel shkalle kurrikulare;
- Hartojnë planin vjetor në nivel klase për një vit shkollor/mësimor;
- Hartojnë planin dymujor të mësimit, duke u mbështetur në planifikimin vjetor;
- Hartojnë planin javor;
- Hartojnë planin e orës mësimore.

## III.1 Plani mësimor

- *Fusha kurrikulare /lëndë mësimore*
- *Orë mësimore*

**Si përgatitet plani mësimor në nivel shkolle?**

Para se të bëhet planifikimi më i detajuar i procesit mësimor për një vit shkollor/mësimor (plani vjetor dhe mujor), së pari duhet përcaktuar saktë planin mësimor për klasën përkatësisht vitin shkollor (mësimor). Në Kurrikulat bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar ekziston një masë lirie në organizimin e planit mësimor. Shih KB-të te pjesa Plani mësimor. Kjo do të thotë se shkolla mund ta hartojë vetë planin mësimor konform kërkesave të KB-ve. Ajo mund të lëvizë numrin e orëve brenda fushës së njëjtë të shkallës kurrikulare nga klasa në klasë apo nga gjysmëvjetori në gjysmëvjetor. Mund të bëjë ndarjen e orëve mësimore në mes të lëndëve të ndryshme mësimore brenda fushës së njëjtë kurrikulare gjatë një viti shkollor, apo për gjitha klasat sa ka shkalla kurrikulare. Por kujdes!, nuk duhet tejkaluar totali i përgjithshëm i fondit javor që është caktuar me Kurrikulën Bërthamë për secilën klasë dhe totali i orëve të fushës kurrikulare brenda shkallës kurrikulare.

Fusha e kurrikulës Artet përfshin si lëndë të obligueshme të Kurrikulës Bërthamë të të tri niveleve formale të arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, lëndët me emërtime Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore në klasën parafillore dhe arsimin fillor (SNKA1) dhe

në shkollën e mesme të ulët (SNKA2), ndërsa në shkollën e mesme të lartë (SNKA 3) Art figurativ dhe Art muzikor.

Edukata muzikore dhe Edukata figurative në planet mësimore në KB planifikohen me një fond të përbashkët të orëve, prej 2 orë në javë, prej klasës parafillore e deri te klasa e 12-të, në kuadër të fushës kurrikulare Artet. Kjo do të thotë se dy lëndët kanë bashkërisht dy orë në javë. Edhe pse plani mësimor në KB lejon fleksibilitet të organizimit të orëve. Shih KB-në plani mësimor, prapëseprapë për shkak të specifikave të këtyre dy lëndëve mësimore sugjerojmë që ndarja 1+1 të përshkojë gjithë vertikalen e shkollimit të përgjithshëm, do të thotë se secila lëndë të jetë prezente në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar me nga një orë në javë. Edhe pse përmes ndërlidhjes lëndore mund të adresohen shumë tema dhe njësi mësimore njëkohësisht nga të dy lëndët mësimore.

Në nivelin fillor preferohet që, për shkak të natyrës së lëndëve specifike të kësaj fushe, të realizohet mësimi në vazhdimësi me formulën 1 orë/javë Ed. muzikore dhe 1 orë/javë Ed. figurative kjo mund të shpërndahet në total, duke u kombinuar p.sh edhe nga 15 minuta në ditë Ed. muzikore ose Ed. figurative me kushtin që gjatë gjithë javës nxënësit t'i jenë të ekspozuar fushës së arteve, për të arritur kompetencat e ndryshme dhe në shërbim të realizimit të temave nga fushat e tjera mësimore.

Shkolla inkurajohet që të organizojë aktivitete ekstrakurrikulare (jashtëkurrikulare), e pse jo edhe përmes Kurrikulës me zgjedhje (lëndëve me zgjedhje), t'u ofrojë nxënësve mundësi që të zhvillohen edhe më tej në fushën e arteve dhe të shprehin talentet e tyre edhe përmes formave të tjera të shprehjes artistike, si: dramës, dizajnit, korit, ansambleve instrumentale, të baletit, vallëzimit etj.

**Aktivitete:**

**Aktiviteti 1:** Provo me kolegë të shpërndash numrin total të fushës së arteve të një shkallë kurrikulare nëpër klasë sa ka shkalla e caktuar kurrikulare. Së pari lexoni në KB pjesën e planit mësimor dhe paraqitni në formë tabelare. Më pas këtë vendoseni në paketën e të gjitha planifikimeve

**Aktiviteti 2:** Me kolegë lexo në KB fushën e Arteve dhe rezultatet e kompetencave dhe përgatitni një planë ideor se çfarë aktivitetesh ekstrakurrikulare (jashtëkurrikulare) do t'u ofroni nxënësve në mënyrë që atyre t'u ofrohen mundësi të shprehen mbi bazën e mundësive, talentit dhe afiniteteve.

## III.2 Plani për shkallë të kurrikulës

- *Rezultate të të nxënit për shkallë - kompetenca (RNSH)*
- *Rezultate të të nxënit për fusha kurrikulare (RNF)*
- *Përcaktimi i temave orientuese për klasa*

Planifikimi në nivel shkalle kurrikulare ndihmon në përcaktimin orientues të procesit mësimor të secilës klasë sa ka shkalla kurrikulare. Gjithashtu sigurohet kontinuitet nga klasa në klasë dhe bëhet evitimi i përsëritjeve të paplanifikuara nëpër klasë brenda një shkalle kurrikulare.

**Si mund të bëhet planifikimi për shkallë kurrikulare?**

Në këtë planifikim bëhet identifikimi i rezultateve të të nxënit për shkallë/kompetenca (RNSH) dhe të fushave kurrikulare (RNF) të shkallës përkatëse, së cilat do të jenë në fokus të arritjes për secilën klasë, me qëllim që mos të bëhet mbingarkimi i njërës nga klasat e shkallës kurrikulare. Gjithashtu krijohet një pasqyrë e përfshirjes së të gjitha rezultateve të të nxënit për kompetenca dhe fusha kurrikulare brenda shkallës kurrikulare.

Mësimdhënësit në këtë planifikim, nëse e shohin të arsyeshme, mund të parashohin edhe elemente të tjera, p.sh. konceptet e fushës, temat mësimore. Mbi bazën e koncepteve dhe rezultateve të identifikuara mund të përcaktohen temat mësimore (TM) për secilën klasë. Këto tema mund të jenë si pika referuese të planifikimit vjetor, por me mundësi ndryshimi gjatë procesit të planifikimit vjetor që bëhen për çdo vit shkollor.

Rezultatet e të nxënit të shkallëve kurrikulare/kompetencave (RNSH), konceptet dhe rezultatet e fushës kurrikulare (RNSH) (në rastin tonë fusha e Arteve) nëpër klasë, vendosen origjinal si janë në Kurrikulën Bërthamë. Mund të ndodhë që këto rezultate të barten nga klasa në klasë, por janë temat mësimore që e bëjnë dallueshmërinë e tyre. Për çështje praktike, sugjerohet që rezultatet të shkruhen me numra dhe të jenë në një rend me temën e përcaktuar që ka dalë nga këto rezultate (shiko shembullin në tabelën në vazhdim). Gjithashtu, në tabelë mund të bëhet planifikimi edhe i të gjitha fushave kurrikulare, në mënyrë që të shohim prezencën e rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare/kompetencë në të gjitha klasat, sa ka shkalla përkatëse, sepse të gjitha rezultatet e kompetencave duhet të arrihen deri në fund të shkallës dhe mund të ndodhë që shkaku i një moskoordinimi jo të mirë midis fushave kurrikulare të mbetet ndonjë rezultat i pasynuar.

Shembuj të tabelave të mundshme të planit për shkallë kurrikulare:

Tab.1 **Shkalla e parë kurrikulare**

| Klasa parafillore | | | | Klasa e parë | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **RNSH-kompetencë** | **Konceptet** | **RNF..... Arteve** | **Tema mësimore** | **RNSH-kompetencë** | **Koncepttet** | **RNF.....** | **Tema mësimore** |
| I.5. Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi-luajtjes me role, këngës apo vallëzimit. | Ed. Muzikore (Kënga<br><br>Ed. Figurative (portret) | I.1.5 Kombinon mjetet shprehëse, fjalën, lëvizjet, mimikën për të realizuar shprehjen artistike. | Kënga<br><br>Portreti ( si teknikë ) | I.5. Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi-luajtjes me role, këngës apo vallëzimit. | Ed. Muzikore(Kënga , vallëzimi)<br><br>Ed. Figurativ(ngjyra ) etj | I.1.5 Kombinon mjetet shprehëse, fjalën, lëvizjet, mimikën për të realizuar shprehjen artistike | **Kënga**<br>( tema e këngës mund te jete e lire ose e lidhur me temat nga fushat e tjera)<br><br>**/Ngjyrimi/pikturimi**<br>Tema e pikturimit ose përdorimit të ngjyrave mund të jetë e caktuar (ilustrim i ngjarjes) ose i lirë( shprehje e përjetimit personal. |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |

P.sh teknika e portretit zhvillohet nëpër nivele të ndryshme.










**Ngjyrosje** **Modelim** **Aplikacion** **Pikturë ( në vaj)**

**Teknika të ndryshme për realizimin e portretit**

Krahas kësaj, nxënësit njihen me portretin dhe teknikat e përdorura gjatë stileve të ndryshme (historikisht) dhe po ashtu njihen me kryeveprat botërore (Monaliza, etj.) dhe ato kombëtare ( Motra Tone) etj.

Tab 2. **Niveli II, shkalla e tretë (klasat VI dhe VII)**

| Fusha kurrikulare | Konceptet e përgjithshme të fushës | Rezultatet | Klasa e gjashtë | Klasa e shtatë |
|---|---|---|---|---|
| **Artet** | | RNF 2 | Ed .muzikore | |
| | Forma<br>Struktura<br>Kompozicioni | **Nxënësi njeh dhe kupton elementet shprehëse, proceset dhe teknikat themelore të krijimtarisë artistike në muzikë, në arte pamore, në art dramatik dhe në vallëzim.** | RNF.2.1 Kupton parimet e ndërtimit te melodisë, harmonisë, ritmit etj. | RNF.2.1Kupton mënyrën e ndërtimit të formës së veprave muzikore në stile të ndryshme (fuga, sonata etj. ) e në zhanre të ndryshme, (këngë popullore, muzikë e lehtë, rok, pop, jazz etj. |
| | | | Ed. Figurative | |
| | | | RNF.2.2 Kupton parimin e kontrastit, raportit hije-dritë në vizatim etj.<br><br>(forma dydimensionale) | RNF 2.2.<br><br>Kupton mënyrat e ndryshme për modelim, skulpturim etj.<br>(Forma tredimensionale) |

Gjatë këtij planifikimi mund të shohim se cilat rezultate (RNSH-kompetenca) ka nevojë dhe duhet t'i përsërisim nëpër klasa. Qëllimi është vetëm të kuptohet ideja se disa rezultate të të nxënit, nëse vlerësohet e arsyeshme, mund të barten nëpër klasa (p.sh. në kl. 6 dhe në kl. 7). Gjithashtu, RNSH-të e njëjta mund të synohen edhe nga fushat e tjera kurrikulare. Rezultatet e kompetencave-RNSH-të, edhe pse barten nga klasa në klasë në kuadër të fushës së njëjtë kurrikulare, mund të ndërlidhen me rezultate të të nxënit, të njëjta apo të ndryshme, të asaj fushe kurrikulare, në këtë rast fushës Arteve.

Çfarë lloj planifikimi për shkallë kurrikulare do të bëjë mësimdhënësi/sja, vendos ai/ajo vetë, por gjithmonë duke pasur në mendje funksionin e atij planifikimi më vonë, në planifikimet vjetore për klasat e shkallës së caktuar kurrikulare.

**Aktivitete:**

**Aktiviteti 1:** Së bashku me kolegë të fushës së Arteve identifiko rezultatet e të nxënit për kompetencë (RNSH) të shkallës së caktuar kurrikulare nga KB-të së cilat do të synoni t'i arrini përmes arteve dhe shpërndani në për klasë brenda shkallës së caktuar kurrikulare. Pastaj diskutoni me kolegët e fushave të tjera kurrikulare (të Këshillit të klasës) dhe shikoni se mos ka mbetur ndonjë rezultat i pasynuar (paplanifikuar).

**Aktiviteti 2:** Së bashku me kolegë të fushës suaj identifikoni konceptet dhe RNF-të nga shkalla kurrikulare, marrë në KB dhe vendosni se në cilat klasë do të synoni t'i arrini, më pas përcaktoni tema mësimore orientuese, të cilat mund të jenë për secilën klasë sa ka shkalla kurrikulare.

## III. 3 Plani vjetor

*Plani vjetor përmban këto elemente:*

- *Konceptet e fushës kurrikulare (Arteve), marrë nga KB për shkallën e caktuar;*
- *Rezultatet e të nxënit për shkallën e caktuar- kompetencat, marrë nga KB;*
- *Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (Arteve), marrë nga KB për shkallën e caktuar;*
- *Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor. Tema shpërndahen (organizohen) në 5 cikle dymujore.*

Plani vjetor është dokument, i cili e orienton zhvillimin e mësimit për një vit shkollor (mësimor) duke i përmbushur kërkesat e shkallës kurrikulare, duke i ndarë apo duke i thjeshtuar për klasën e caktuar. Ai hartohet për secilën fushë kurrikulare dhe ka për qëllim identifikimin e rezultateve të të nxënit të kompetencave, të cilat mund të jenë si synim arritjeje gjatë një viti shkollor (mësimor), identifikimin e koncepteve dhe rezultateve të të nxënit të fushave kurrikulare nga të cilat do të përcaktohen përmbajtjet mësimore. Ky planifikim mbështetet në planifikimin për shkallë kurrikulare, por edhe kërkon konsultë të vazhdueshme të KB-së, respektivisht të shkallës së caktuar kurrikulare.

**Si bëhet planifikimi vjetor?**

**Shembull:** Hapat që duhet ndjekur për planifikim vjetor, klasa e parë, por duke konsultuar KB-në, fushën e arteve.

| Hapi 1 → | Hapi 2 → | Hapi 3 → | → Hapi 4 |
|---|---|---|---|
| **RNSH –kompetencat** | **Konceptet** | **RNF** | **Tema mësimore** |
| I.5. Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi-luajtjes me role, këngës apo vallëzimit. | Ed. Muzikore (kënga, vallëzimi)<br><br>Ed. Figurativ (ngjyra) etj. | I.1.5 Kombinon mjetet shprehëse, fjalën, lëvizjet, mimikën për të realizuar shprehjen artistike. | **Kënga**<br><br>( tema e këngës mund të jetë e lirë ose e lidhur me temat nga fushat e tjera).<br><br>**/Ngjyrimi/pikturimi**<br>Tema e pikturimit ose përdorimit të ngjyrave mund të jetë e caktuar (ilustrim i ngjarjes) ose i lirë (shprehje e përjetimit personal. |

Mund të ndiqen edhe këta hapa, por **gjithnjë duke konsultuar KB-në,**fushën e Arteve:

| Hapi 1 | hapi 2 | hapi 3 | Hapi 4 |
|---|---|---|---|
| **Konceptet** | **RNF** | **Tema mësimore** | **RNSH –kompetencat** |
| Ed. Muzikore (kënga, vallëzimi)<br><br>Ed. Figurativ(ngjyra) etj | **Shembull mund të synohen**<br>**I.1.1**<br>**I.1.2**<br>**I.1.3**<br>**I.1.4**<br>**I.1.5** | Ed. Muzikore (kënga, vallëzimi)<br><br>Ed. Figurativ (ngjyra) etj. | I.5. Shpreh mesazhin e dhënë të një teksti të thjeshtë letrar të lexuar, përmes njërës nga format shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimi-luajtjes me role, këngës apo vallëzimit.<br><br>**Shembull: Mund të synohen edhe I.1, I.2, I.3, V.1 V.2, ... .** |

**Reflekto!** Meqenëse në klasën parafillore dhe arsimin fillor shembuj përmbajtjesorë për arritjen e kompetencave nga të gjitha fushat kurrikulare merren nga jeta, atëherë edhe temat mësimore në këtë nivel mund të kenë kësi emërtimesh, si Unë dhe familja, Unë dhe mjedisi, etj. Koncepte e fushës, respektivisht njësitë mësimore të lëndëve të arteve, mund të jenë në shërbim të këtyre temave, p.sh. kënga për nënën ..., 8 Marsi, etj.

U mbetet mësimdhënësve të vendosin se me çfarë hapa do të bëjnë planifikimin.

RNSH shih në KB të secilit nivel, konceptet kryesore dhe RNF për fushën Arteve i gjeni në Kurrikulat Bërthamë (KB) të niveleve përkatëse, 1,2 dhe 3.

Pasi që përcaktojmë konceptet dhe rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare (RNSH), atëherë përcaktojmë përmbajtjen mësimore (temat mësimore).Përmbajtja mësimore duhet të jetë në funksion të mësimdhënies së integruar brenda fushës kurrikulare, por edhe të fushave të tjera kurrikulare. Puna me tema të përbashkëta mësimore brenda fushës kurrikulare dhe lidhshmëria me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare janë në linjë të mësimdhënies dhe të nxënies së integruar, e cila duhet të synohet në vazhdimësi. **Temat mësimore** janë tërësi mësimore, të cilat mbulojnë apo përfaqësojnë të gjitha lëndët mësimore brenda një fushe kurrikulare.

***Shembull:*** *Një temë që mund të jetë e vlefshme për gjitha lëndët e fushës kurrikulare (bile edhe për të gjitha fushat) për klasën e I, p.sh mund të jetë: Tema mësimore ( globale)* ***Unë****, me disa nëntema si,* ***Unë*** *dhe familja,* ***Unë*** *dhe mjedisi shoqëror,* ***Unë*** *dhe mjedisi natyror. Fusha Artet kontribuon në mënyra të ndryshme në përpunimin e këtyre temave, duke u ndërlidhur edhe me lëndët e tjera me qasje integruese. Ndërlidhja bëhet në kuadër të njësisë konkrete mësimore që është pjesë e temës.*

Unë dhe familja ( familja e ngushtë, e gjerë etj.)

KARAKTERISTIKAT E PERSONALITETIT (karakteri, dëshirat, qëndrimet etj.)

Unë dhe mjedisi shoqëror( Lagja, shtëpia ime , shkolla, shoqeria)

UNË

KARAKTERISTIKAT FIZIKE (Flokët, sytë, dukja, gjatësia etj)

KARAKTERISTIKAT KULTURORE, veshjet, lodrat, gjësendet, kultura (sjelljet, qëndrimet) , preferencat etj.

Artet kontribuojnë në të gjitha këto tema e nëntema përmes veprimtarive artistike, p.sh në lëndën Edukatë muzikore këndohen këngë për këto tema e nëntema ( Nëna ime, Babi im, Shkolla ime, Vendi im, Shokët e mi, Unë kam një qen, Vjeshta, etj.), por këto tema e nëntema mund të jenë subjekt i të shprehurit kreativ përmes lëndës së Edukatës figurative. Shih planifikimin vjetor për klasën e parë.

Gjithashtu, gjatë identifikimit të rezultateve të të nxënit të fusha kurrikulare Artet **mësimdhënësit mund të hasin në rezultate që janë specifike vetëm për një lëndë mësimore** dhe në këtë rast ndonjë temë mësimore mund t'i dedikohet vetëm një lënde mësimore. Por, është qasje e KKK-së drejt mësimdhënies dhe nxënies së integruar, andaj duhet synuar përcaktim të temave mësimore në atë mënyrë që të adresohen nga të gjitha lëndët mësimore të fushës Artet.

P.sh. Çështja e masës kohore, tonalitetit apo rinjohjes së veprës muzikore, i përket vetëm muzikës, kurse modelimi me materiale të ndryshme, ngjyrat dhe karakteristikat janë çështje që i takojnë vetëm Artit figurativ.

Por, këto tema, sidomos në nivelin e parë, sugjerohet që të trajtohen në nivel të përjetimit estetik dhe të aplikimit konkret, kurse njohuritë më të thelluara (teorike) për mjetet shprehëse artistike dhe teknikat përkatëse do të realizohen në dy nivelet e tjera të sistemit arsimor. Gjithashtu, temat mësimore duhet të kenë edhe një rend logjik për sa i përket shkallës së vështirësisë.

Temat mësimore mund të jenë prezente për disa muaj gjatë vitit shkollor (mësimor), por edhe gjatë tërë vitit shkollor. Kjo varet nga nevojat e nxënësve dhe nga rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare. P.sh.

| Koncepti | RNF | Tema | IX - X | XI-XII | I-II | III-IV | V-VI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Këndimi<br><br>Vizatimi | I.1.5 | Kënga<br><br>Punimi i pavarur krijues | √ | √<br><br>Une dhe mjedisi natyror ( vendi, natyra, fshati-qyteti etj) | √ | √ | √ |
| | | | | | | | |

Për secilën temë mësimore duhet caktuar edhe rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare /kompetencë (RNSH) që synohen të arrihen nga tema në fjalë. Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare – kompetencë, mund të shënohen me numra rendorë, ashtu siç janë në KB-të për shkallën përkatëse. Për çështje praktike edhe rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare (RNF), po ashtu edhe të temës mësimore, mund t'u vendoset nga një numër rendor. Numrat rendorë të jenë të njëjtë për rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare dhe temës mësimore që korrespondojnë me njëri-tjetrin.

Me rastin e planifikimit vjetor mund të shfrytëzojmë burime të ndryshme që na ndihmojnë në identifikimin e nivelit shkencor të temave mësimore të përzgjedhura, por edhe të

nivelit pedagogjik në raport me moshën e nxënësve. Gjithashtu, identifikimin e burimeve bazë për nxënës që janë në funksion të arritshmërisë së kompetencave dhe rezultateve të fushave kurrikulare.

-Rezultatet e shkallës

- Rezultatet e fushës

- Rezultatet e lëndës

→ Burime të shkruara dhe elektronike - TEMAT



→ Suksesi



Temat mësimore pas përzgjedhjes shpërndahen në ciklet dymujore të planifikimit vjetor. Shih tabelën e planifikimit vjetor të procesit mësimor.

**Tabela e planit vjetor të procesit mësimor**

Viti shkollor ........... Klasa.........

| **Fusha e kurrikulës** | **Koncep tet e fushës kurrik ulare, marrë nga KB** | **Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare ,marrë nga KB** | **Temat mësimore** që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilën fushë kurrikulare | **Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve** | | | | | **Rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare-kompetenca, marrë nga KB** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Shtat or-tetor | Nëntor –dhjetor | Janar-shkurt | Mars -prill | Maj – qershor | |
| **Artet** | | | | | | | | | |
| Gjuhët dhe komunikimi | | | | | | | | | |
| Matematika | | | | | | | | | |
| **...** | | | | | | | | | |

Pasi që mësimdhënësit të bëjnë planin vjetor për fushën e kurrikulës Artet sugjerohen që më pas me mësimdhënësit e fushave të tjera bashkërisht të gjitha planifikimet vjetore t'i vendosin në një tabelë të vetme, në mënyrë që ndërlidhja ndërmjet fushave kurrikulare të bëhet më lehtë dhe gjithashtu kontrollimi i përfshirjes së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare (kompetenca).

Kjo na mundëson të kem një pasqyrë të saktë të përfshirjes së rezultateve të të nxënit të shkallëve kurrikulare (kompetencave) në planifikime. Nëse nuk bëhet planifikimi vjetor për gjitha fushat kurrikulare në një tabelë të vetme, së paku tabelat e planit vjetor të të gjitha fushave kurrikulare të vendosen afër, që të shikohet në mënyrë globale si po kontribuojnë të gjitha fushat e kurrikulës gjatë një viti shkollor në arritjen e kompetencave të caktuara.

**Udhëzime për plotësim të tabelës**

- Ky format i tabelës përdoret për planifikim për secilën klasë;
- **Shkollat profesionale,** pas titullit të tabelës, shkruajnë edhe profilin arsimor;

- Planifikimi për të gjitha fushat kurrikulare të jetë i shkurtër dhe i qartë. Kjo formë e planifikimit u mundëson të gjitha fushave kurrikulare të kenë qasje te njëra-tjetra dhe hetohet që në shikim të parë;

- Me rastin e hartimit të temave mësimore merren për bazë konceptet e fushës kurrikulare dhe rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare (RNF), e në këtë rast të fushës kurrikulare Artet. Ato merren nga Kurrikula Bërthamë për shkallë. Konceptet e fushës kurrikulare janë të vlefshme për gjithë shkallën, përkatësisht për gjithë arsimin parauniversitar (shih KB-fushat e kurrikulës), por mësimdhënësi mbi bazën e këtyre koncepteve duhet të seleksionojë temat për secilën klasë sa ka shkalla;

- Në kolonën e emërtuar **Konceptet e fushës kurrikulare** shënohen vetëm ato koncepte që trajtohen në klasën e caktuar, por të gjitha ato domosdoshmërisht duhet trajtuar gjatë shkallës kurrikulare. Konceptet merren nga KB te fusha e Arteve;
- Në kolonën e emërtuar **Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare** vendosen rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare Artet, vetëm ato që reflektohen në temë mësimore, pra vetëm ato nga të cilat dalin temat mësimore origjinale, marrë nga KB;
- Në kolonën e emërtuar **Temat mësimore që trajtohen gjatë një viti mësimor për secilin fushë kurrikulare** shënohen të gjitha temat mësime që do të trajtohen brenda një viti shkollor (mësimor). Temat mësimore përbëhen prej disa njësive mësimore. Në këtë tabelë shkruhen vetëm temat e jo njësitë mësimore. Temat mësimore janë të vlefshme për të gjitha lëndët që ka një fushë. Njësitë mësimore janë ato që i bëjnë të dallojnë lëndët brenda fushës së njëjtë kurrikulare. Njësitë mësimore, edhe pse janë të ndryshme nga lënda në lëndë, brenda fushës kurrikulare ato synojnë temën e përbashkët, secila prej këndit të lëndës së vet.
- Në kolonën e emërtuar **Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve** bëhet shpërndarja e temave të përzgjedhura për një vit mësimor nëpër muaj;

Në shtrirjen dymujore temat zbërthen me më pak fjalë se çfarë do të trajtohet brenda tyre (shumë shkurt - ndoshta në formë të nëntemave me disa sqarime po në formë të pyetjeve-aktiviteteve).

Shih shtojcën planifikimet vjetore, konceptet e fushës kurrikulare Artet, tema mësimore e mundshme Unë dhe shoqëria;

Brenda dy muajsh mund të jenë disa tema mësimore, 1, 2 tema apo më shumë, varësisht sa mësimdhënësi mendon se janë të nevojshme të trajtohen brenda muajve (preferohet numri i vogël i temave). Disa tema mund të jenë prezente edhe në muajt e tjerë, kuptohet me njësi të reja mësimore. Renditja e temave nëpër muaj sugjerohet të bëhet sipas një rendi logjik.

- Në kolonën rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare – kompetenca, shkruhen vetëm rezultatet për kompetenca që mendohet se duhet të arrihen përmes temave për secilën fushë. Këto rezultate mund t'i gjeni te rezultatet e të nxënit të shkallëve kurrikulare;

Në këtë kolonë rezultatet i shënoni vetëm me numra rendorë, ashtu origjinale si janë në KB;

Mësimdhënësi i përcakton se cilat kompetenca–rezultate të të nxënit për shkallë- kompetenca synon t'i arrijë përmes fushës kurrikulare gjatë një viti mësimor, respektivisht përmes temës mësimore;

Bashkërisht të gjitha fushat kurrikulare për sa klasë që ka shkalla duhet synuar të arrijnë të gjitha rezultatet e kompetencave, d.m.th, nëse shkalla i ka tri klasë atëherë për tri vite shkollore-mësimore një gjeneratë që i takon shkallës së caktuar duhet t'i arrijë të gjitha rezultatet e kompetencave të parapara për shkallën e caktuar në Kurrikulën Bërthamë;

Mësimdhënësit duhet të vendosin se cilat nga rezultatet e të nxënit- kompetencës për shkallë të caktuar do t'i arrijë në secilën nga klasat sa ka shkalla e caktuar kurrikulare, shembull shkalla e parë, cilat në klasën parafillore, cilat në klasën e parë dhe cilat në klasën e dytë;

Ka raste kur një rezultat i ndonjë kompetence mund të synohet të arrihet në dy klasë apo tri radhazi, i mbetet mësimdhënësit të vendosë. **Kujdes, rezultatet duhet të arrihen nga secili nxënës;**

- Gjithashtu duhet konsultuar kalendarin shkollor.

**Procedurat e nevojshme për plotësim të tabelës**

- Tabela punohet nga aktivet profesionale të shkollës, e në këtë rast edhe nga aktivi profesional i Arteve;
- Për secilën fushë kurrikulare punojnë bashkërisht mësimdhënësit e lëndëve që i takojnë fushës së caktuar kurrikulare. Kjo vlen për shkollën e mesme të ulët dhe shkollën e mesme të lartë. Pra, mësimdhënësit e lëndëve mësimorë Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore planifikojnë bashkërisht;

- Në shkallën e parë dhe të dytë (shkollë fillore) punojnë të gjithë mësuesit e paraleleve sa ka klasa e caktuar, por në këtë grup duhet të kontribuojë një përfaqësues i secilës fushë kurrikulare të shkollës së mesme të ulët;
- Pasi që planifikimi vjetor punohet për fushën e caktuar për klasën e caktuar, atëherë mblidhet Këshilli i klasës së caktuar dhe bashkërisht planifikimin e secilës fushë e vendosin në formatin/ tabelën e përbashkët. Gjatë vendosjes në këtë tabelë, përfaqësuesit e fushave të klasës së caktuar (në shkollën fillore mund të jetë mësues klase) diskutojnë për përmbajtjen dhe kompetencat që synon t'i arrijë secila fushë për klasën e caktuar, në mënyrë që ndërlidhja në mes fushave të jetë sa më prezente.

Aktiviteti1: Me kolegë të fushës tuaj identifikoni RNSH/kompetenca të një shkalle të caktuar, që mund të realizohen përmes fushës së Arteve gjatë një viti shkollor (konsulto planifikimin për shkallë). Më pas identifikoni RNF që korrespondojnë me RNSH dhe caktoni temat mësimore.

Aktiviteti 2: Me kolegë të fushave të tjera kurrikulare diskutoni se cilat rezultate të kompetencave po synoni t'i arrini dhe mundohuni të bëni ndërlidhjen e temave tuaja mësimore me temat e tyre mësimore.

**Dhe, në fund përgatitni planifikimin vjetor për fushën e arteve.**

## III.4 Plani dymujor

*Plani dymujor përmban këto elemente: Temat mësimore, RNSH (kompetenca), RNF, korrelacionin dhe çështjet ndërkurrikulare, lëndën mësimore, RNL, njësitë mësimore, kohën e nevojshme, metodologjitë e mësimdhënies, vlerësimit dhe burimet.*

**Si bëhet plani dymujor?**

Planifikimi dymujor është vazhdimësi e planifikimit vjetor të procesit mësimor dhe si tërësi e këtyre planifikimeve ka formatin e një programi mësimor. Gjatë një viti shkollor (mësimor) bëhen pesë plane dymujore. Ky plan hartohet për dy muaj dhe vetëm për një temë mësimore. Kjo do të thotë nëse në planin vjetor është paraparë që brenda dy muajve të trajtohen dy tema mësimore, atëherë duhet bërë dy plane dymujore për muajt e njëjtë. Plani mund të bëhet në të njëjtin formular- tabelë, vetëm me vazhdimësi.

Planifikimi dymujor ka për qëllim zbërthimin e temave mësimore të fushës së përbashkët kurrikulare në njësi mësimore nga lëndët mësimore. Njësitë mësimore bashkërisht duhet të kenë për synim arritjen e rezultateve të identifikuara të të nxënit të shkallës kurrikulare (kompetencave) dhe të fushës kurrikulare të synuara të arrihen nga tema e caktuar mësimore. Gjithashtu, planifikimi dymujor ka për qëllim identifikimin e rrugëve (metodologjisë), mjeteve (materialeve) dhe burimeve për arritjen dhe vlerësimin e nivelit të arritjes së këtyre rezultateve. Elementet e planifikimit dymujor shihni në tabelën e emërtuar **Plani dymujor i procesit mësimor.**

Tema mësimore e përzgjedhur mund të ketë lidhshmëri edhe me temat mësimore të fushave të tjera kurrikulare. Këtë lidhshmëri duhet shikuar në planifikimin e përbashkët vjetor me fushat e tjera kurrikulare, me qëllim që të bëhet pjesë e planifikimit dymujor dhe kështu të mundësohet mësimdhënia dhe të nxënit e integruar.

***P.sh.,** tema mësimore Kënga mund të ndërlidhet me shumë tema nga fushat e tjera mësimore, sidomos me letërsinë ose historinë etj.*

*Po ashtu edhe tema mësimore Puna krijuese e pavarur( në ed .figurative) mund të jetë e ndërlidhur me tema nga fushat e tjera (shëndeti dhe mirëqenia, historia, letërsia etj.*

Po ashtu, pjesë e planifikimit mund të jenë çështjet ndërkurrikulare, si të drejtat e njeriut, çështjet gjinore..., të cilat mund të korrespondojnë me temën e përzgjedhur. Shih pjesën çështjet ndërkurrikulare në KB - në përmbajtjen e secilës fushë kurrikulare.

*P.sh., nëse për temë mësimore në fushën kurrikulare Artet në klasën e parë për dy muaj trajtojmë familjen, atëherë mund të ndërlidhemi me çështjet gjinore sa u përket përgjegjësive në familje, duke përdorur teknikat e ndryshme shprehëse figurative (vizatim, modelim, ngjyrim etj.), ose duke aktivizuar në mënyrë të njëjtë si vajzat si djemtë në veprimtaritë e ndryshme muzikore ( këndim, dëgjim muzikë, krijimtari etj....po ashtu mund të këndohen këngë të ndryshme me tema të ndërlidhura për këto çështje*

Planifikimi dymujor i temës mësimore u mundëson lëndëve mësimore të një fushe kurrikulare, përmes njësive mësimore, arritjen e përbashkët të rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare, por secilës nga këndi i vet. Ky planifikim bëhet nga mësimdhënësi i lëndës.

Zbërthimit të temës mësimore në njësi mësimore duhet t'i paraprijë zbërthimi i rezultateve të fushës kurrikulare Artet në rezultate të të nxënit për lëndë mësimore për klasën e caktuar, në këtë rast në rezultate për lëndën Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore. Nga rezultati i fushës mund të dalin disa rezultate të të nxënit për lëndë mësimore për klasën e caktuar.

Mësimdhënësi–ja gjatë zbërthimit të rezultatit të fushës (RNF) në rezultatet e të nxënit për lëndë – klasë (RNL), qoftë për Edukatë figurative apo për Edukatën muzikore, mund të shfrytëzojë planet dhe programet ekzistuese apo rezultatet përfundimtare marrë nga tabela krahasuese e rezultateve të fushës kurrikulare të KB-ve me rezultatet e pritshme të planeve dhe programeve ekzistuese për shkallën e caktuar, respektivisht klasat e caktuara, të cilat i ka krahasuar vetë (shih material më lart, II.3.3 Rezultatet e të nxënit për klasë në nivel të fushës kurrikulare apo lëndës mësimore (RNL), brenda shkallës kurrikulare). Nga kjo tabelë mund të zgjidhen vetëm ato rezultate që janë në funksion të rezultatit të fushës nga i cili është dalë tema mësimore. Në të kundërtën, mësimdhënësi-ja mund edhe t'i hartojë vetë. Pas shkrimit të rezultateve të lëndës mësimore (fushës kurrikulare) për klasë përcaktohen njësitë mësimore. Një rezultat i lëndës mund synohet me një njësi mësimore, apo më shumë.

Shih skemën e zbërthimit të rezultateve të fushës kurrikulare (RNF) në rezultate të të nxënit për lëndë për klasë (RNL), nga të cilat dalin temat mësimore (TM) dhe njësitë mësimore (NJM) dhe shembullin procesit të përcaktimit të njësive mësimore.




**Shembull**: Procesi i përcaktimit të njësive mësimore

| Hapi 1 | hapi 2 | hapi 3 | Hapi 4 | Hapi 5 |
|---|---|---|---|---|
| **RNSH (kompetenca)** | **RNF- Artet** | **Tema mësimore** | **RNL . Edukatë figurative** | **Njësia mësimore** |
| | 6. **Identiteti dhe kultura**<br>6.1 Përjeton dhe njohin kryeveprat e artit popullor kombëtar dhe komuniteteve të tjera, p. Sh. Interpreton këngët, vallet kombëtare dhe të popujve të tjerë, **përdor motive figurative kombëtare edhe të kulturave të tjera në punimet e veta.** | Kënga (popullore)<br><br>Vallja (popullore)<br><br>6. Stolitë dhe artefaktet popullore | 6.1. Interpreton këngë (popullore)<br><br>6.2. Krijon punime artistike me motive popullore | Kënga "Çu mbush prilli"<br><br>Qilimi tradicional |

Përzgjedhja e njësive mësimore, sikurse temat mësimore, duhet të jetë konform përvojave, mundësive, interesave të nxënësve, të ndërlidhura me jetën dhe të jenë aktuale.

**Tabela e planit dymujor, e procesit mësimor**

**Fusha**: Artet
**Klasa:** ..............................
**Muajt**:
**Tema mësimore:**........................................
**Rezultatet e kompetencave që synohen të arrihen përmes temës:**
**Rezultatet e fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës:**
**Korrelacioni me fushat kurrikulare:**
**Çështjet ndërkurrikulare:**

| Fusha apo lëndët mësimore | Rezultatet e të nxënit të lëndës | Njësitë mësimore | Koha e nevojshme | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Edukatë figurative | | | | | | |
| Edukatë muzikore | | | | | | |

Mund të punohet një tabelë vetëm për një lëndë mësimore, p.sh. Ed. figurative apo vetëm për Ed. muzikore, por sugjerohet që planifikimi të vendoset në format të përbashkëta dhe të diskutohet për lidhshmërinë brenda fushës kurrikulare, gjithnjë në fokus RNF dhe RNSH e përbashkëta.

***Udhëzime për plotësim të pjesës narrative dhe tabelës***

***Pjesa narrative***

***Planifikimi***

*Planifikimi dymujor sipas këtij formulari bëhet për një temë mësimore. Nëse brenda dy muajsh në planifikim vjetor janë paraparë dy apo më shumë tema, atëherë duhet për secilën temë të bëhet planifikimi. Planifikimi mund të bëhet në të njëjtin formular (tabelë), në vazhdimësi.*

*Secila lëndë e fushës kurrikulare duhet të pasqyrohet në tabelën e përbashkët për temën e përbashkët.*

***Temat mësimore***

*Tema mësimore merret nga tabela e planifikimit vjetor të temave të fushës së kurrikulës (artet) sipas planifikimeve për dy muaj, respektivisht shtrirjes dymujore.*

***Rezultatet e të nxënit për shkallë të kompetencave***

*Nga kompetencat që janë paraparë të arrihen te planifikimi vjetor - marrë nga KB, barten vetëm ato rezultate të të nxënit për shkallë RNSH- kompetenca që synohen të arrihen përmes temës mësimore - përmes lëndës mësimore. Tani rezultatet shkruhen me numra rendorë dhe me narracion si janë në KB. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate.*

***Rezultatet e fushës kurrikulare***

*Shënohen vetëm ato rezultate të të nxënit të fushës kurrikulare që synohen të arrihen përmes temës së caktuar mësimore nga lënda mësimore e fushës së caktuar. Rezultatet duhet të merren nga planifikimi vjetor që janë marrë nga KB - shkalla e caktuar kurrikulare. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate. Është mirë që për çështje praktike edhe rezultateve të fushave kurrikulare t'u vendosen numrat rendorë të njëjtë. ashtu si u kemi vendosur në planifikimin vjetor. Gjithashtu t'u shkruhet edhe narracioni, siç janë në KB.*

***Korrelacioni dhe çështjet ndërkurrikulare***

*Korrelacioni bëhet mbi bazën e planifikimit vjetor të fushave kurrikulare. Me pak fjalë përshkruani korrelacionin e temës që planifikohet me temat e fushave të tjera. Duhet të bëhet ndërlidhja e temës mësimore me çështjet ndërkurrikulare, si: të drejtat e njeriut, toleranca,... shih KB- çështjet ndërkurrikulare.*

***<u>Plotësimi i tabelës</u>***

***Lëndët mësimore***

*Shënohen lëndët mësimore që janë në kuadër të fushës kurrikulare dhe që trajtojnë temën e përbashkët, por secila nga këndi i vet, në këtë rast Edukata figurative apo Edukata muzikore.*

***Rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore***

*Mësimdhënësi-sja shkruan rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore (Ed. figurative apo Ed. muzikore) nga të cilat dalin njësitë mësimore. Në këtë rast mund t'i konsultojë - merr nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me KB-të. Mund të jenë një, dy apo më shumë rezultate. Por, edhe mund t'i hartojë vetë.*

*Secilit rezultat të të nxënit të lëndës t'i vendoset një numër rendor.*

***Njësitë mësimore***

*Njësitë mësimore shënohen për lëndë mësimore (Ed. figurative apo Ed. muzikore). Mësimdhënësi-ja përcaktohet për ato njësi mësimore që dalin nga rezultatet të nxënit të lëndës mësimore për klasë dhe që janë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës dhe kompetencave të caktuara për temën e përbashkët të fushës kurrikulare Artet.*

***Koha e nevojshme***

*Mësuesi duhet të konsultojë planin mësimor që e ka zbërthyer nga KB për klasë. Ai vendos sa kohë (orë mësimore) i nevojitet, përmes njësive mësimore, të arrihen rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore, zhvillimit të kompetencave të caktuara te nxënësit (arritshmërinë e rezultateve të të nxënit të fushës kurrikulare dhe kompetencave).*

***Metodologjia***

*Të shkruhet në formë të aktiviteteve, duke i përmendur metodat dhe teknikat e mësimdhënies dhe të të nxënit, jo shumë të detajuara, sepse kjo bëhet në planin e orës mësimore.*

***Vlerësimi***

*Vlerësimi të paraqitet në formë të aktiviteteve dhe me çfarë instrumente bëhet ai . p.sh test, ese, listë kontrolli, pyetësori etj.*

***Burimet dhe materialet mësimore***

*Të shkruhen burimet që mësimdhënësi dhe nxënësit i shfrytëzojnë për arritjen e rezultateve të caktuara. Ato mund të jenë të ndryshme (burimet e shkruara, elektronike, njerëzore etj.)*

*Burimet e shkruara mund të jenë tekste mësimore, gazeta, revista, dokumente dhe materiale të ndryshme.*

*Burimet elektronike interneti-ueb faqja , TV-kanali-emisioni, radio.*

*Burimet njerëzore mund të jenë njerëzit që janë pjesë e një historie, ngjarje, pune, etj.*

*Materialet mësimore: Instrumentet muzikore apo materiale të nevojshme për reaklizi në lëndën e Edukatës figurative.*

**Sugjerim**

*Një planifikim i mirë kërkon bashkëpunim brenda aktiveve profesionale, Këshillit të klasës, d.m.th. mësimdhënësve të Ed. figurative dhe Ed. muzikore apo të Artit figurativ dhe artit muzikor, edhe pse këtë e bën secili mësimdhënës për lëndën që e mban!*

**Shembull** i plotësimit të tabelës së planit dymujor, klasa VI

| Lënda | Rezultatet e të nxënit të lëndës | Njësitë mësimore | Koha e nevojshme | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Edukatë figurative | 1. Përdor tekniken e lapsit dhe raportin dritë- hije.<br><br>2.<br>3. | 1. Pushimi dimëror<br><br>2.<br>3. | 1 orë | 1. Metodat bashkëbisedue se, audiovizuele, etj.<br><br>Teknikat-që zhvillojnë të menduarit kritik. | 1. Vlerësimi individual<br><br>2.<br>3. | 1.Teksti shkollor aktual, fotografitë, interneti, etj.<br><br>2.<br>3. |
| Edukatë muzikore | 1. Identifikon raportin në masën dykohore përmes interpretimit të këngës se mësuar,<br>Njeh vlerën e notës katërshe.<br><br>1.1 interpreton ushtrime ritmike në masën dy kohore. | 1.Triola | 2 orë | 1. Demo nstrim<br>Punë me tekst<br>Interpretim muzikor. | Interpretim i ushtrimit ritmik në masën dy kohore<br><br>identifikim i shenjës për vlerën e notës katërshe. | Libri shkollor i muzikës<br><br>Materiale nga interneti (youtube- Duhet adresa e saktë). |

**Aktivitet:** Pasi që i keni lexuar dhe analizuar udhëzimet e dhëna për PLANIFIKIMIN DYMUJOR, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe përgatiteni një plan dymujor për fushën e kurrikulës Artet.

## III.5 Plani javor

Meqenëse plani dymujor nuk është i ndarë në javë, plani javor mundëson përcaktimin e njësive mësimore, të cilat do të realizohen gjatë javës për secilën lëndë mësimore (fushë kurrikulare), në klasën e caktuar. Njësitë mësimore merren nga planifikimi dymujor.

Planifikimi javor ka për qëllim lidhshmërinë e njësive mësimore të lëndëve të ndryshme mësimore në kontekst të kuptimit të situatave, problemeve, dukurive dhe ngjarjeve si çështje të ndërlidhura e jo të ndara.

**Si bëhet plani javor?**

Të gjithë mësimdhënësit/set e një klase (p.sh. kl. 6), të të gjitha fushave kurrikulare, të të gjitha lëndëve, në një tabelë të përbashkët të vendosin njësitë mësimore që i kanë planifikuar t'i realizojnë gjatë javës për një klasë (edhe pse ato mund të jenë të ndryshme nga arsimtarët e së njëjtës lëndë, por që japin mësim në paralele të tjera brenda klasës së njëjtë).

Kjo qasjeje i obligon mësimdhënësit që të takohen gjatë javës dhe që të bëhet lidhshmëria e njësive mësimore në mes lëndëve të ndryshme, në mënyrë që të nxënit e nxënësve të jetë më i integruar.

Nëse ky takim për shkollat e mesme të ulëta dhe të larta nuk mund të jetë i realizuar në të gjitha shkollat, sepse "kolektivi i mësimdhënësve është shumë i madh", atëherë kryetari i Këshillit të klasës mund të qarkojë fletën-tabelën në të cilën mësimdhënësit shkruajnë njësitë mësimore që do t'i zhvillojnë javën që vjen, ose pedagogu i shkollës në shkollat ku ka pedagog. Më pas kjo fletë-tabelë e përfunduar shumëzohet ose shpërndahet në mënyrë elektronike te të gjithë mësimdhënësit/set e klasës së njëjtë para javës që realizohen njësitë mësimore.

Është e nevojshme që planifikimi javor të publikohet edhe në sallën e mësimdhënësve, në mënyrë që të gjithë mësimdhënësit të jenë në dijeni se cilat tema/njësi mësimore realizohen gjatë javës dhe të ndihmojnë integrimin përmbajtjesor të fushave dhe lëndëve të kurrikulës.

Qasja e prezantimit/publikimit të planit javor para të gjithë mësimdhënësve është një qasje e re në traditën e planifikimit mësimor, jetësimi në praktikë i kërkon bashkëpunim brenda aktiveve profesionale, bashkëpunim në mesin e të gjithë mësimdhënësve. Vlerësohet se kjo qasje mund të ndikojë në lehtësimin e të nxënit të nxënësve, në zvogëlimin e ngarkesës së nxënësve në provime dhe testime, sidomos nëse bëhet kujdes që të vendosen tema/njësi mësimore ndihmohen reciprokisht në mes të fushave të kurrikulës dhe lëndëve mësimore dhe nëse bëhet një përshkrim i shkurtër i metodologjisë dhe aktiviteteve që do të zhvillohen brenda një klase të caktuar.

Para se të bëhet planifikimi javor i gjitha lëndëve mësimorë sa ka klasa e caktuar, në këtë rast është mirë që edhe mësimdhënësit e fushës së arteve së pari të koordinojnë planifikimin e tyre për javë për të qenë të gatshëm për planifikim të përbashkët me të gjitha lëndët mësimore në nivel klase. Shih shembujt më poshtë.

**Shembull:** Planifikimi javor brenda fushës Artet

**Plani javor i mësimit të fushës Artet**

Në shkollën e mesme të lartë lëndët e fushës së arteve kanë këto emërtime: Edukatë figurative dhe Edukatë muzikore.

| Java e parë<br>MUAJI nëntor, VITI SHKOLLOR 2013/2014 | | |
|---|---|---|
| **Klasa :** | **X** | **X** |
| **Mësimdhënësi/sja:** | | |
| **Lënda:** | **Edukatë figurative** | **Edukatë muzikore** |
| **Tema:** | | |
| **Korrelacioni:** | | |
| **Kryetari i Këshillit të klasës së dhjetë:** | | |

**Shembull** i një **plani javor, i të gjitha fushave kurrikulare** (lëndëve mësimore), që është bërë nga mësimdhënësit e shkollës fillore dhe që mund të adaptohet për klasat e niveleve të tjera formale.

| **Dita** | **Njësitë mësimore në javë** | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **E hënë** | 1. Gjuhë dhe komunikim | 2. Gjuhë dhe komunikim | 3. Matematikë | 4. Artet Ed. figurative | Gjatë kësaj jave do të diskutohet për udhëtimet dhe aventurat, p.sh në fushën Shoqëria dhe mjedisi, e cila do të jetë pikë referimi i fushave të tjera kurrikulare si:<br><br>Matematikë –Gjatë punës me libër kemi ilustrime të trenit, zhytësit. Numërimi i vagonëve të trenit.<br><br>Gjuhë dhe komunikim : Zhvillimi i shkronjës dhe tingullit H dhe T ( hëna, treni, helikopteri).<br><br>Shkencat e natyrës Gjatë orës mund të diskutojmë për mjetet e udhëtimit se kur lëvizin për sa mund të lëvizin prej një vendi në vendin tjetër etj.<br><br>Jeta dhe puna – Diskutojmë për rregullat në trafik të mjeteve të udhëtimit ( rregulla të thjeshta).<br><br>Shëndeti dhe mirëqenia : Luajmë lojën Treni ku fëmijët imitojnë zhurmën e trenit dhe renditen si lokomotivat. |
| | Lexim në abetare f. 45 | Paraqitja e tingullit dhe shkronjës H,h. Grafiku i shtypit f. 46 | Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 9 F. pune f. 36 | Vizatojmë:Trenin, topin,hënën | |
| **E martë** | 1. Matematikë | 2. Gjuhë dhe komunikim | 3. Gjuhë dhe komunikim | 4. Shoqëria dhe mjedisi | |
| | Zbatime të mbledhjes dhe zbritjes me problem f. 54 | Shkronja e madhe dhe e vogël H,h ( grafiku I dorës ) f. 47 | Anglisht | Mjetet e udhëtimit | |
| **E mërkurë** | 1. Matematikë | 2. Artet, Ed. muzikore | 3. Gjuhë dhe komunikim | 4. Zgjedhore-Lexim shkrimi | |
| | Numri 10 f. 57 | Mësohet kënga Tapshin tapshin | Plotësim në Abetare pune f. 36 | Diktim | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **E enjte** | 1. Gjuhë dhe komunikim | 2. Matematikë | 3. Shkencat e natyrës | 4. Shëndeti dhe mirëqenia | |
| | Lexim dhe plotësim në abetare f. 47 | Numrat prej 1 – 10 f. 58 | Matja e kohës: ora,dita,nata | Loja e trenit | |
| **E premte** | 1. Gjuhë dhe komunikim | 2. Matematikë | 3. Jeta dhe puna | 4. Shëndeti dhe mirëqenia | |
| | Paraqitja e tingullit dhe shkronjës T,t. Grafiku i shtypit f. 48 | Mbledhja dhe zbritja e numrave deri në 10 | Trafiku f. 13 (punë dore) | Orientimi në natyrë | |

Aktivitet: *Pasi që keni analizuar shembullin e dhënë për PLANIFIKIMIN JAVOR, diskutoni me kolegë të fushës së kurrikulës dhe përgatitni një plan javor* ***për fushën e kurrikulës Artet*** *dhe pastaj, bashkë me kolegët e fushave, respektivisht të lëndëve të tjera mësimore përgatitni një plan javor për të gjitha lëndët.*

## III.6 Plani i orës mësimore

Plan i orës mësimore ka për qëllim që të gjitha planifikimet e procesit mësimor t'i bëjë të zbatueshëm në punën e drejtpërdrejtë me nxënësit-set në klasë, por edhe jashtë saj, brenda një ore mësimore.

**Çfarë duhet të përmbajë plani i orës mësimore?**

Në këtë planifikim mësimdhënësi-ja përcakton:

- Njësinë mësimore, të cilën do ta realizojë (njësia mësimore merret nga planifikimin dymujor, përkatësisht planifikimi javor);
- Rezultatet e të nxënit të synuara për shkallë-kompetenca (të cilat i ka përcaktuar në planifikimin dymujor të temës mësimore);
- Rezultatet e të nxënit të synuara të fushës kurrikulare **Artet;**
- Rezultatet e të nxënit të lëndës mësimore /orës (edukatë figurative apo edukatë muzikore) që korrespondojnë me rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare **Artet** - edhe këto merren nga planifikimi dymujor;
- Kriteret e suksesit, të cilat duhet të caktohen në bashkëpunim me nxënësit në fillim të orës dhe duhet të jenë në shërbim të rezultatit, apo rezultateve të të nxënit të lëndës /orës.

Të gjitha rezultatet e kompetencave, të fushave kurrikulare dhe të lëndëve mësimore, duhet të shënohen me numra rendorë të njehtë, si janë në planifikimin vjetor e më pas në planifikimin dymujor, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë të realizimit, përkatësisht arritshmërisë së tyre.

Mbi bazën e rezultateve të kompetencave dhe të fushës kurrikulare, mësimdhënësi-ja e elaboron orën mësimore duke përcaktuar edhe elemente të tjera, të cilat i sheh të nevojshme. Mënyra organizative e orës mësimore - metodologjia e mësimdhënies dhe e vlerësimit, metodat, teknikat, mjetet dhe burimet që shfrytëzohen për realizim të njësisë mësimore duhet të jenë në funksion të rezultateve të të nxënit të planifikuara për arritje.

Mësimdhënësi mund të **përdorë formate të ndryshme** të planifikimit të orës mësimore, por çdoherë duhet pasur parasysh rezultatet e të nxënit të kompetencave dhe të fushave kurrikulare. Shih format e mundshme të planit mësimor.

**MODEL I PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE**

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE** |
|---|
| Fusha kurrikulare: / Lënda: Shkalla e kurrikulës: / Klasa: |
| Koncepti bazë i fushës së kurrikulës:<br>Tema / njësia mësimore: |
| Kontributi në rezultatet e kompetencave kryesore për shkallën ____: |
| Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën ____: |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Fjalët kyçe: |
| Rezultatet e të nxënit të lëndës/orës (RNL):<br><br>Kriteret e suksesit: |
| Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore : |
| Përdorimi i TIK-ut: |
| Korrelacion me fushat kurrikulare apo çështje ndërkurrikulare: |
| **PËRSHKRIMI METODOLOGJISË DHE RRJEDHËS SË PLANIFIKUAR TË ORËS MËSIMORE** |
| **Pjesa hyrëse:** |
| **Pjesa kryesore:** |
| **Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit:** |

Shih në udhëzues se çka janë korrelacioni dhe çështjet ndërkurrikulare

**Aktivitet :** Mbi bazën e këtij modeli apo modelit tuaj të planifikimit të një orë mësimore <u>përgatit një plan të orës mësimore</u> dhe mundohu të parashikosh se si do t'i synosh RNSH dhe RNF.

## III.7 Çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare

Çështjet ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lënde. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare (mësimore) dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritshmërisë së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimit për paqe, të drejta e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit, edukimin për karrierë dhe aftësitë për jetë.

**Si realizohen çështjet ndërkurrikulare?**

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në Kurrikulë nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Kështu, me rastin e përzgjedhjes së përmbajtjeve mësimore në fusha të caktuara kurrikulare, pra edhe në Arte, këto çështje duhet të merren parasysh. P.sh. nëse në Edukatën figurative për njësi mësimore kemi Peizazh nga natyra, apo nga Edukata muzikore këngë që ka të bëjë me natyrën, përpos funksionit të tyre, këto njësi mësimore që kanë në arritjen e rezultateve të të nxënit në fushën e tyre ato, *mund të jenë edhe në funksion të ndërgjegjësimit për mjedisin, duke kontribuar në ruajtjen dhe kultivimin e tyre. Në këtë rast ndihmojmë nxënësit në arritjen e kompetencës kontribuues produktiv, (shih në KB rezultatet e kësaj kompetence).*

*Gjithashtu, gjatë planifikimit preferohet që këtyre temave* t'u jepet hapësirë e veçantë në data të caktuara, si p.sh. Ditës së tokës, Ditës së drejtave të fëmijëve, etj.

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të bëhet edhe përmes projekteve hulumtuese dhe projekteve të natyrave të ndryshme, p.sh. projekteve promovuese (të vlerave shoqërore, produkteve), projekteve parandaluese, etj. Për realizimin e këtyre projekteve mund të kontribuojnë disa fusha kurrikulare, p.sh. në hulumtimin e shkeljes së drejtave të fëmijëve mund të kontribuojnë fushat kurrikulare Gjuhët dhe komunikimi, përmes mënyrës së shkrimit dhe prezantimit të hulumtimit; Matematika, përmes analizave matematikore të të dhënave; Shkencat e natyrës, përmes trajtimit të materialeve të dëmshme si kimikalet gjatë punëve që bëjnë fëmijët në kopsht; Shëndeti dhe mirëqenia, përmes trajtimit të shëndetit fizik dhe emocional; Shoqëria dhe mjedisi, përmes analizës së konventave të fëmijëve; Jeta dhe puna, përmes trajtimit të rreziqeve në punë, pastaj përdorimi i teknologjisë elektronike për hulumtim dhe prezantim dhe gjithashtu rreziqet nga përdorimi i teknologjisë elektronike ('Facebook'-ut…), **Artet përmes mesazheve vizuele (posterëve, pikturë, grafikeve), por edhe auditve (instrumentaleve apo këngëve) dhe formave të tjera, duke organizuar ekspozita, koncerte etj.**

**Si realizohet korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare?**

Suksesi i gjithë zbatimit të KB-së qëndron në trajtimin e integruar të temave mësimore nga kënde të ndryshme të fushave kurrikulare. Kjo u mundëson nxënësve të kuptojnë funksionimin e jetës gjithnjë e më shumë të ndërlidhur.

Realizimi i korrelacionit bëhet në të gjitha planifikimet mësimore, p.sh. në planifikimin për shkallë, në mënyrë studiuese bëjmë shpërndarjen e RNSH dhe RNF për secilën klasë. Në planifikimin vjetor përcaktojmë tema mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore sa ka fusha kurrikulare. Gjithashtu, kërkohet që planifikimet vjetore të të gjithave fushave kurrikulare të vendosen në formatin e njëjtë, me qëllim të funksionimit të korrelacionit në mes tyre. Në planifikimet vjetore vetëm kërkohet të shkruhet korrelacioni dhe kështu vijmë te planifikimi javor, i cili për qëllim ka pikërisht korrelacionin ndërmjet fushave kurrikulare, përkatësisht lëndëve mësimore (shih më lart udhëzuesin, pjesën III. 5, plani javor). Kjo ndërlidhje më pas reflektohet edhe në orën mësimore. Shih shembujt në vijim:

**Ndërlidhja e fushës së Arteve me Historinë, klasa VI.**
P.sh. Në Histori si njësi mësimore mund të mësohet Qytetërimi Romak;
Njësi mësimore në Edukatën figurative mund të jenë Kultura figurative e asaj kohe, kurse nxënësit inkurajohen edhe të punojnë punime artistike me teknika të asaj kohe (medaljone argjilli, mozaiqe, etj)....Në Edukatën muzikore si njësi mësimore mund të jenë Muzika në atë periudhë të qytetërimit, instrumentet muzikore të asaj kohe; të njihet ndonjë krijues, vepër ose/dhe interpretues muzikor i asaj periudhe etj.

**Për më shumë, shih KB-të, fushën e Arteve, pjesën çështjet ndërkurrikulare**

**Aktiviteti 1:** Diskuto me kolegët e fushës së Arteve dhe identifikoni disa çështje ndërkurrikulare, të cilat mund t'i trajtoni në lëndët mësimore që ju i mbani.

Aktiviteti 2: Vrojto planifikimin javor të përgatitur bashkërisht me kolegët e të gjitha lëndëve mësimore dhe identifiko lëndët mësimore, respektivisht njësitë mësimore me të cilat mund t'i ndërlidhësh njësitë mësimore të lëndës të cilën e mban.

# IV. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, MATERIALET MËSIMORE, VLERËSIMI DHE INSTRUMENTET E SAJ

**Rezultatet e pritshme për këtë kapitull**

Në fund të këtij kapitulli mësimdhënësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë metoda, teknika dhe strategji të mësimdhënies me në qendër nxënësin dhe që nxisin të menduarit kritik dhe krijues;
- Identifikojnë qasje, strategji dhe burime për përgatitjen dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore;
- Identifikojnë strategji, teknika dhe instrumente për vlerësim të arritjeve të nxënësve dhe punës së vetë mësimdhënësit;
- Identifikojnë strategji të bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve për zbatim të KKK-së.

## IV.1 Metodologjia e mësimdhënies në funksion të zbatimit të KKK-së dhe KB-ve

Pasi që kemi bërë planifikimin me kohë dhe të thuktë të KB-ve, duke e zbërthyer atë për nevojat dhe mundësitë e nxënësve, atëherë veç fillojmë realizimin praktik të saj. Kjo do të thotë se ne kemi bërë planifikimin për shkallë kurrikulare, planifikimin vjetor dhe dymujor të procesit mësimor, planifikimin javor dhe të orës mësimore dhe i kemi ndërlidhur ato në mënyrë logjike dhe kështu jemi gati për zbatim praktik, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj, si në realizimin e aktiviteteve brenda orës mësimore, në dhënien e detyrave të shtëpisë, po ashtu edhe në aktivitetet jashtëkurrikulare. Në këtë rast na mbetet vetëm të zbatojmë metodologjitë e mësimdhënies së planifikuar.

Artet edukojnë në mënyrë të suksesshme vetëm kur aplikohet me saktësinë më të madhe metodologjia speciale përkatëse e mësimdhënies dhe e nxënies artistike në secilën prej disiplinave artistike (muzikë, arte pamore, dramë, vallëzim etj.). Metodika e mësimdhënies në lëndët që rrjedhin nga këto disiplina përfshin teknikat mësimore dhe metodat specifike të mësimit të koncepteve, shkathtësive dhe njohurive që nxënësit duhet t'i arrijnë përmes këtyre lëndëve mësimore. Përjetimi artistik, kërshëria, imagjinata dhe liria e të shprehurit, janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Duke supozuar se në nivelin e parë kryesisht mësimdhënia orientohet drejt përjetimit artistik dhe inkurajimit për t'u shprehur përmes artit në nivelin e parë, në dy nivelet e tjera të arsimit parauniversitar ne mënyrë graduale nxënësit njihen me konceptet e ndryshme, dukuritë dhe fenomenet artistike përmes mësimdhënies intuitive dhe qasjes konstruktive të të nxënit, por edhe për teknikat dhe proceset e krijimtarisë muzikore, figurative, dramatike etj.

Në secilën lëndë të veçantë të fushës Artet, nxënësit njohin dhe kuptojnë proceset dhe teknikat krijuese, duke mësuar si t'i zbatojnë në praktikë mjetet e ndryshme të të shprehurit artistik për të realizuar veprat/interpretimet e tyre artistike. Mësimin e realizojnë mësimdhënësit specialistë të lëndëve përkatëse artistike që me kujdes i zhvillojnë shkathtësitë artistike të nxënësit sipas prirjes individuale dhe interesimit të tyre.

KKK-ja avokon që të realizohet mësimdhënia me nxënësin në qendër, prandaj mësimdhënësi i artit është më tepër organizator dhe inkurajues për zhvillimin e aftësive krijuese e performuese të nxënësve.

Zbatimi i mësimdhënies me nxënësin në qendër krahas njohurive për planifikim dhe vlerësim të nxënies në bazë të rezultateve të të nxënit, kërkon njohuri profesionale, por edhe shkathtësi metodike specifike për realizimin e lëndës së caktuar. Mësimdhënësi i muzikës duhet të dijë të këndojë, të luajë në instrument, të dirigjojë, të aranzhojë këngë e melodi për formacione të ndryshme (këngë njëzëshe për shumë zëra, melodi për instrumente të ndryshme etj.). Mësimdhënësi i artit duhet të dijë të vizatojë, të ngjyrosë, të modelojë, etj., por edhe t'i njohë teknikat, stilet e krijimtarisë së figurative.

**Si mund të përzgjidhet metodologjia e mësimdhënies në funksion të kompetencave?**

Rezultatet e të nxënit për shkallë - kompetencë (RNSH) dhe rezultatet e të nxënit për fusha kurrikulare (RNF), përveç që janë pika referuese të përzgjedhjes së përmbajtjes mësimore, temave mësimore respektivisht njësive mësimore në planifikimet e procesit mësimor, ato na ndihmojnë edhe në përzgjedhjen e metodologjisë së mësimdhënies dhe të të nxënit konform filozofisë dhe parimeve të KKK-së. (shih me lart dokumentin në pjesën II.2, parimet e arsimit parauniversitar si referenca të organizimit të punës edukativo-arsimore dhe pjesën e planifikimit-modelet e planifikimeve mësimore), respektivisht përzgjedhjen e teknikave dhe strategjive të mësimdhënies.

**Teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies artistike**

Kur kemi të bëjmë me mësimdhënien në lëndët artistike duhet t'i kemi parasysh disa aspekte dhe t'i parashtrojmë vetes disa pyetje konkrete?

Cilat shkathtësi dua t'i zhvillojë te nxënësit e mi? Cilat njohuri dua që t'i përfitojnë nxënësit e mi? Çka dua që të ndjejnë nxënësit e mi për këtë mësim dhe për këtë fushë tematike? Cilat besoj se do të jenë rezultatet e të nxënit? Cilat kompetenca do të vazhdojnë zhvillohen më tej?

*Cilat aktivitete mësimore do t`i përfshij në realizimin e orës?*
Përse kam zgjedhur këto aktivitete/strategji?
Si mund ta realizoj mësimin dhe t'i bëj aktivitetet interesante për nxënësit?

Në planin e orës mësimore mësimdhënësi saktësisht duhet të shënojë aktivitetet të cilat mendon që t'i organizojë për ta arritur RNF/RNL e caktuar dhe RNSH/ kompetencën/at që synon të zhvillojë. Aktivitetet mësimore ndërlidhen (kushtëzohen) nga teknikat mësimore që në fushën e artit mund të quhen edhe veprimtaritë artistike-mësimore.

Në artin muzikor mësimdhënia realizohet përmes tri veprimtarive kryesore muzikore: Interpretim (këndim, luajtje ne instrumente), Dëgjim dhe Krijim(Kreativitet).

Në artin figurativ po ashtu mësimdhënia realizohet përmes veprimtarive të ndryshme të bazuara në teknikat e ndryshme si: vizatim, pikturim, modelim, konstruksion, Art aplikativ etj. Për secilën nga këto veprimtari janë paraparë rezultate konkrete të të nxënit dhe për t'i realizuar ato nevojiten materialet didaktike të veçanta e burimet mësimore specifike.(p.sh te këndimi, është procedura konkrete si mund të mësohet kënga me imitim ( në nivelin e parë) dhe me nota (tekst notal) më nivelet e tjera. Në veprimtaritë (teknikat) e Artit figurativ mund të përdoren mjete e materiale specifike (lapsi, ngjyrat, materiale të ndryshme për modelim). Për të arritur suksesin e dëshiruar mësimdhënësi duhet që:

- Të krijojë mjedis mësimor mbështetës (me mjete adekuate, raporte pozitive etj.);
- *Të inkurajojë të nxënit reflektiv dhe veprues*, (nxënësi reflektues përvetëson njohuritë e reja duke i ndërlidhur ato me atë se çfarë ai di, i përshtat ato me synimet të cilat i kthen në veprime mësimore). Roli i mësuesit në këtë fazë nuk është që të japë këshilla apo zgjidhje për problemin mësimor, por të inkurajojë nxënit për vlerësimin e përmbajtjes së detyrës/kërkesës së dhënë, qoftë mësimore apo edhe veprim për zhvillimin e ndonjë shkathtësie, qëndrimi apo vlere shoqërore);
- *Të shtojë lidhjen me të nxënit e ri* (dijen, shkathtësinë e re), (është vërtetuar se nxënësit janë shumë më të suksesshëm kur janë mirë të njohur me përmbajtjen (çka) mësojnë, pse duhet ta mësojnë atë, por edhe si do të mund ta përdorin atë njohuri, shkathtësi në jetën e përditshme. Për këtë arsye me shumë rëndësi është që mësuesi të nxisë kureshtjen e nxënësve, të kërkojë nga ata që të hulumtojnë të dhëna që lidhen me dijen/njohurinë, shkathtësinë që zhvillohet te ta, por edhe duke i sfiduar ata që ato t'i përdorin në kontekst dhe në rrugë/mënyrë të re. Me shumë rëndësi: inkurajimi i nxënësve që të marrin vetë vendime për të nxënit e tyre (çka, si dhe pse?);
- *Të ndihmojë/lehtësojë pjesëmarrjen e nxënësve në mësim*;
- *Të vendosë ndërlidhjen midis përvojës me të nxënit pararendës*, (mënyrë shumë e mirë, dhe e pranueshme për të nxënës të suksesshëm, nëse krijojmë mundësi nxënësit që t'i ndërlidhin njohjen e re me përvojën dhe dijet paraprake, të cilat vetëm i kanë. Mësimdhënësi duhet të ndihmojë nxënësit që ta ndërlidhin të nxënit e ri me të nxënit përgjatë fushave mësimore, por edhe me të nxënit në jetën e përditshme (në shtëpi dhe nga burimet e tjera të të nxënit). Të nxënit vertikal dhe horizontal (kurrikular) është vendimtar për zhvillimin e kompetencave të parapara;

- *Të ofrojë mundësi të mjaftueshme për të nxënë* (secilit nxënës). Është vërtetuar se nxënësit janë shumë më të suksesshëm në rast se përfshihen në procesin e nxënies, aktivitet mësimor praktik, sidomos nëse atij i mundësohet bartja e të njëjtës informatë (dije) te të tjerët. Organizimi i të nxënit garues, me projekt, zgjidhje të problemeve, luajtje e rolit, debati mësimor janë me shumë rëndësi për të nxënë të suksesshëm dhe të qëndrueshëm, me këtë edhe zhvillim i kompetencave të caktuara. Roli lehtësues i mësimdhënësit këtu është i pazëvendësueshëm. Për ta realizuar këtë me sukses atij i duhet që të përgatis edhe materiale për zbatimin e teknikave dhe strategjive mësimore.

**Inkorporimi i të gjitha këtyre elementeve vjen në pah gjatë planifikimit të njësisë mësimore. Aty duhet të niset mësimdhënësi nga rezultati i të nxënit, përcaktimin e temës, zgjedhjen e strategjisë, teknikave mësimore, burimeve e materialeve.**

**MODEL I PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE** me shembuj të respektimit të parimeve të kurrikulës dhe të synimit të kompetencave

| **ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE** |
|---|
| Fusha kurrikulare: Artet / Lënda: Edukatë muzikore / Shkalla e kurrikulës: I / Klasa: I |
| Koncepti bazë i fushës së kurrikulës: Interpretim, këndim, prezantim<br><br>Tema / njësia mësimore; Mjedisi natyror; stinët. Mësimi i këngës "Dimri" sipas veshit. |
| Kontributi në rezultatet e kompetencave III.2 dhe V.5 |
| Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës për shkallën I:<br><br>1.1.1. Këndon këngë e melodi të thjeshta, sipas imitimit<br><br>1.1.4. Lëviz në mënyrë kreative e në përputhje me melodinë, ritmin karakterin shprehës. |
| **ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIFIKIMIT TË ORËS MËSIMORE** |
| Fjalët kyçe: Dimri, koha e ftohte, atmosfera e zymte, stina (karakteristikat), kënga, lojërat në dimër, ngjyra e bardhë etj. |
| Rezultatet e të nxënit të orës mësimore /lëndës RNL **( Ky apo këto rezultate merret nga planifikimi dymujor)**: Këndon këngën me ritëm e intonacion të saktë, sipas imitimit, individualisht dhe në grup.<br><br>Kriteret e suksesit: 1. Niveli i lartë: (4) = 5<br><br>a) Këndon me ritëm dhe intonacion të saktë e me emocion, b) shqipton saktë tekstin e këngës, c) lëviz në përputhje me ritmin, karakterin e këngës dhe shprehjen emocionale.<br><br>*Respektohet parimi i përgjegjësisë dhe llogaridhënies*<br><br>2. Niveli i mesëm: (3)= 4,3<br><br>a) Këndon me ritëm mesatarisht saktë dhe ka probleme me intonacion, por ka emocion, b) shqipton tekstin me probleme, c) lëviz, por jo në përputhje me ritmin dhe karakterin e këngës.<br><br>3. Niveli bazik (2)=2<br><br>a) Mundohet t'i shoqërojë të tjerët gjatë këndimit, ka probleme të theksuara në ritëm dhe intonacion, por tregon interesim për pjesëmarrje dhe ka emocion, b) nuk mban mend tekstin e këngës gjatë këndimit, c) lëviz, por jo krejtësisht në përputhje me ritmin dhe karakterin.<br><br>Niveli i dobët (0) =1 |

a) Nuk merr pjesë fare në këndim, as nuk reagon emocionalisht gjatë këndimit, b) nuk e shqipton mirë tekstin, nuk merr pjesë në recitimin dhe ligjërimin e tij, c) fare nuk reagon me lëvizje.

Mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto ose video-pamje , sint ose piano, duartrokitjet, instr. ritmike, lëvizja.

Përdorimi i TIK: video-pamje, PPT

Korrelacioni dhe çështjet e ndërkurrikulare (mbrojtja e mjedisit): (njeriu dhe natyra), stinët, dimri, mësimi i tekstit të këngës (bën lidhje me gjuhen), lëvizjet që do t'i realizojnë qoftë për të realizuar ritmin e këngës apo për të paraqitur karakterin e saj (gërshetohen elementet me ed. fizike). Mund të bëjmë lidhje edhe brenda fushës, p.sh.nëse pas mësimit të këngës do të realizojmë me nx. ndonjë vizatim apo edhe bëjmë lidhje asociative me ndonjë vizatim që e kanë vizatuar më parë për stinën e dimrit.

Respektohet parimi i mësidhënies së integruar

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHLE RRJEDHËS SË PLANIFIKUAR TË ORËS MËSIMORE**

**Pjesa hyrëse:** 5 minuta

Paraqitja e fotove ose video-pamjeve të stinës së dimrit, shoqëruar me muzikë (dimri nga Vivaldi"Stinët e Vitit";

Biseda e realizuar me teknikën **Stuhi mendimesh, për atë se çfarë asociojnë pamjet** dhe muzika që shoqëron.

NË KËTË MËNYRË KRIJOJMË ATMOSFERË RELAKSUESE PËR TË FILLUAR MËSIMIN E KËNGËS.

**Pjesa kryesore: 30 minuta**

**Prezantimi i plotë i këngës (demonstrimi/këndimi)**

- **Mësimdhënësi demonstron/interpreton këngën me të gjitha elementet e këndimit të drejtë dhe të bukur duke e përcjellë këndimin në instrument (***pritet reagimi emocional nga nxënësit për të filluar procedurën e mësimit të këngës) (5 min).*
- **Mësimdhënësi prezanton/ reciton tekstin e këngës me emocion** (*zhvillon bisedë për përmbajtjen dhe fjalët e reja, kërkon nga ndonjë nxënës të interesuar për ta përsëritur tekstin) (5 min).*
- **Mësimdhënësi demonstron/interpreton gjithë tekstin me ritëm duke e ligjëruar ritmikisht dhe duke e shoqëruar me lëvizjen e**

*Synohen kompetencat III.2, Nxënës i sukseshëm, sepse nxënësit ndjekin udhësimet e mësimdhënëses*

*V.5 Individ i shëndosh, sepse bashkëpunon me të tjerët për arritjen e qëllimit të përbashkët.*

**dorës për të mbajtur ritmin dhe tempin.**

**Di –mri- er –dhi... etj/ (shemb, me rrokje) (** 5min**).**

- **Nxënësit imitojnë mësimdhënësin me punë në grupe (një grup metrin, një grup –ritmin) dhe mësim frontal (të gjithë) (**15 min.**), (frazë pas fraze).**

**m**____________________________________________________________

**gr I (**_________________________________________________________

**gr II**

____________________________________________________________

Metodat e punës: punë në grupe, një grup/ritmi, një grup/melodia, një grup nxitet të lëvizë sipas ritmit dhe karakterit të veprës.

**Pjesa përfundimtare dhe vlerësimi i të nxënit: 10 minuta**

Përsosja e këngës, këndim individual dhe kolektiv, me shoqërim në instrument nga mësimdhënësi dhe me lëvizje nga nxënësit;

Këndim alternativ( fillon një grup, vazhdon grupi tjetër) për të vlerësuar memorien dhe aftësinë për intonim të saktë ( instrument vlerësimi);

Vëzhgimi dhe plotësimi i tabelës vlerësuese sipas kritereve (shembulli i tabelës) për secilin nxënës.

**AKTIVITET:**
Zgjidhni RNF dhe RNL për lëndën e caktuar dhe klasën e caktuar, përcaktoni temën/njësitë me të cilat mendoni se do të adresohet rezultati i të nxënit të orës mësimore (RNL) që keni zgjedhur. Përcaktoni strategjitë, teknikat, burimet me të cilat do të adresonit arritjen e rezultateve.

## IV.2 Materialet mësimore (përzgjedhja dhe përgatitja e tyre)

Planifikimet mësimore me qasje të re u mundësojnë mësimdhënësve të jenë autonomi në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimdhënies dhe gjithashtu të materialeve mësimore.

**Si ndihmojnë materialet mësimore në zhvillimin e kompetencave?**

Mësimdhënësit mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuara dhe parimeve të KKK-së. Përzgjedhja adekuate e materialeve konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për fushën e Arteve.

Artet i kanë mjetet e tyre shprehëse, teknikat dhe procedurat specifike që kushtëzojnë përdorimin e  mjeteve materialeve të ndryshme për realizimin e përmbajtjeve nga kjo fushë kurrikulare. P. sh., në Edukatën figurative materiali mësimor përkon me materialin e punës, si: letra, pëlhura, plastelina, materiale organike etj. Përpos materialeve, shfrytëzohen edhe burime mësimore, si: teksti shkollor, fotografitë, videoja, interneti etj.

Në Edukatën/ Artin muzikor materiali kryesor është vetë tingulli muzikor që prodhohet nga zëri i njeriut ose instrumentet muzikore. Burimet mësimore përfshijnë edhe tekstin shkollor dhe burimet tingëllore (CD-të përkatëse, CD-të muzikore, DVD-të, incizimet nga interneti, TV-të, koncertet publike etj.).

*Ja një shembull i përdorimit të materialeve të ndryshme për të bërë vepër art. Dordoleci i punuar nga nxënësit e kl. III/5, shkolla fillore 'Naim Frashëri', Prishtinë, materiali i përdorur gota të plastikës për një përdorim! Letër shumëngjyrëshe dhe kapëse metali!*



**Mjetet e nevojshme për realizimin e mirëfilltë të mësimit në fushën Artet**

Mësimdhënia në lëndët artistike kërkon mjetet adekuate në shkollën/klasën ku ata zhvillojnë mësimin. P.sh. për lëndën e eduatës muzikore është e domosdoshme të sigurohen burimet auditive si cd-player dhe instrumenti muzikor (piano, sintisajzer) kurse për Edukatën figurative përpos materialeve janë të domosdoshme mjetet audio-vizuele si: DVD, projektor dhe mund të përdor uebfaqe nga të cilat mund të shkarkojnë materiale të ndryshme, qoftë auditive apo vizuele. Të nxënit në lëndët artistike, sidomos për nxënësit e moshës më të re, realizohet vetëm përmes konkretizimit të të koncepteve artistike që rëndom janë abstrakte (ritmi, harmonia, dinamika, etj).

Por, shkollat tona nuk shquhen shume në këtë drejtim. Nuk janë të pajisura me këto mjete të domosdoshme, andaj mësimdhënësi shpesh detyrohet të sigurojë vetë mjetet për konkretizim. Shkollat të cilat kanë hapësirë të mjaftueshme mund të krijojnë qendrën e burimeve në të cilat krijojnë dhe i ruajnë mjetet mësimore, ose shkolla mund të pasurojë me mjetet e duhura kabinetet e posaçme (kabineti i muzikës, kabineti i artit etj).

Por, **një pjesë të madhe të burimeve mësimore mund t'i krijojnë vetë edhe mësimdhënësit bashkë me nxënësit.** P.sh. (instrumente ritmike me materiale të ndryshme (kuti të mbushura me misër, grurë etj); daulle (nga materiale të ndryshme), përdorimin e lugëve të drurit, metalit, pjatave metalike, zileve të ndryshme...pra çdo burim tingëllor mund të përdoret në klasë.

Në art përdoren materiale artistike si shembull, model, stimulim dhe frymëzim artistik. Këtu hyjnë pikturat, fotografitë, modelet e ndryshme (maketa, punime etj.), veprat muzikore për dëgjim, këngët që përzgjedhen për t'u kënduar, etj.

Ato duhet të gjitha të përzgjidhen mbi bazën e dy kritereve kryesore:

a) Të kenë vlerë artistike;
b) Të jenë të përshtatshme për moshën e nxënësve dhe aftësitë e tyre përjetuese, performuese e krijuese.

P.sh. nëse një vepër muzikore që përzgjidhet për dëgjim në klasën e parë, mund te jetë një vepër me vlerë artistike të lartë, por me gjuhë shprehëse, formë e teknika që janë të vështira për t'u përjetuar artistikisht dhe intelektualisht nga nxënësit e kësaj moshe të re, ajo nuk e realizon funksionin për të cilin po përdoret në mësim.

Mësimdhënësit në përgjithësi duhet të kujdesen gjatë zgjedhjes së materialeve mësimore, duke marrë në konsiderim:

- Me çfarë materiale më mirë arrihen rezultatet e të nxënit për tema të caktuara mësimore;
- Materialet duhet të jenë interesante, atraktive dhe inkurajuese për lexime punë të pavarur ( fletë pune, fletë aktivitete, materialet vizuele ndihëse (harta, diagrame, posterë, etj) të cilat mumd edhe të hartohen nga vetë nxënësit me ndihmën e mësimdhënësve;
- Materialet duhet të jenë të përshtatshme në kuptimin etik dhe moral dhe të përshtatshme për moshën e nxënësve;
- Materialet janë të përshtatshme për kontekstin në të cilin nxënësit jetojnë dhe shkollohen
- Materialet duhet të kenë vlerë artistike dhe edukative dhe të jenë të llojlloshme ( libër,artikull, raporte, intervista, pikturë, fotografi, film, video, emisione dokumentare, blog, materiale on-line ( ueb-faqe, video), vepër muzikore, bisedë, vizitë studimore më galeri, muze, natyrë, institucion etj).
- Materialet duhet të jenë të përshtatshme për diversitetin etnik, religjioz, social dhe kulturor.














**Aktivitet**: Përcaktohuni për materialet më të përshtatshme për të realizuar temën/njësinë e caktuar mësimore në funksion të realizimit të një rezultati të caktuar të të nxënit për lëndën e caktuar në kuadër të fushës Artet (të Edukatës muzikore dhe të Edukatës figurative).

## IV.3 Aspektet metodologjike dhe praktike të vlerësimit

> *Vlerësimi është proces i mbledhjes së informatave dhe i nxjerrjes së gjykimeve lidhur me arritshmërinë ose performancën e nxënësve. Shih fjalorthin në KKK*

Pas gjithë përgatitjeve për një fillim të mbarë të procesit mësimor (kujto llojet e planifikimeve dhe metodologjitë e mësimdhënies), interes i mësimdhënësit është përcjellja dhe vlerësimi i vazhdueshëm i secilit nxënës në kontekstin e arritjes së rezultateve të planifikuara për periudha të caktuara kohore. Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënit në nivel shkalle kurrikulare (kujto RNSH-kompetenca dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore e të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht KB për tri nivelet e arsimit parauniversitar. Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi e vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve të që janë planifikuar në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore. Mbi mesataren e vlerësimit të vazhdueshëm, respektivisht mbi mesataren aritmetike të notave numerike që nxënësi është vlerësuar nga mësimdhënësi gjatë tërë vitit shkollor bëhet vlerësimi përfundimtar në nivel klase dhe për secilën mesatare nxënësit i vendoset e nota shkronjë siç është paraparë në KB. Me të njëjtën procedurë duhet vazhduar me vlerësimin edhe në klasat pasuese përbrenda shkallës së caktuar kurrikulare dhe kështu për të arritur te vlerësimi përmbyllës në nivel shkalle kurrikulare (lexo procedurat e vlerësimit përfundimtar dhe përmbyllës në KB.)

Për të konstatuar nivelin e arritjes së rezultateve të planifikuara në planifikime duhet kërkuar çdoherë prova dhe dëshmi në performancat e secilit nxënës-e.



**Çfarë duhet bërë që vlerësimi të jetë efektiv?**

Duke u nisur nga të kuptuarit praktik të konceptit të vlerësimit, mësimdhënësi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve së pari duhet të caktojë **qëllimin** i vlerësimit, apo duhet bërë vetes pyetjen **pse po dëshiroj të vlerësoj**? P.sh. **po vlerësoj për të planifikuar**, **po vlerësoj për të konstatuar nivelin e progresit** të arritjeve të kompetencave, apo rezultateve të fushave kurrikulare, lëndës mësimore, njohuritë akademike të nxënësve, po vlerësoj **për të përmirësuar mësimdhënien**, vlerësoj përvojat e nxënësve, mënyrën e të nxënit (stilet), etj. Vlerësimi çdoherë duhet jetë i planifikuar me kohë, e ndoshta edhe të bëhet edhe pjesë përbërëse e planifikimeve mësimore (shih planifikimin dymujor dhe të orës mësimore – kriteret e suksesit).

**Cilat procedura mund të ndjekim që të matim progresin në arritjen e rezultateve të kompetencave?**

Nëse dëshirojmë të matim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim këtë procedurë:

- Së pari për fushën e caktuar kurrikulare përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i matim;
- Pastaj përcaktojmë nivelin e arritjes të kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate siç e dimë duhet të arrihen deri në fund të shkallës, prandaj edhe duhet zbërthyer për klasë (kujto zbërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë! Shih pjesën e udhëzuesit kur flitet për rezultatet e të nxënit për shkallë – kompetencë /RNSH dhe arritshmëria e tyre, shembullin e zbërthimit të rezultatit I.7);
- Më pas caktohet tema a njësia mësimore përmes së cilës matim rezultatin e kompetencës;
- Dhe në fund caktohet teknika dhe instrumenti adekuat përmes të cilës matet rezultati i kompetencës (RNSH). Kujto, rezultatet e kompetencave nuk janë vetëm njohuri, por edhe shkathtësi, qëndrime, vlera dhe rutina. Shih KB fushat kurrikulare, pjesën e vlerësimit.

**P.sh.** *Te klasa III nxënësit mësojnë vizatimin e lirë, ku përmes imazheve të paraqitura ata zhvillojnë njohuritë, qëndrimet, shkathtësitë, duke realizuar paraqitjen e një objekti të caktuar.*
**Qëndrimet, vlerat dhe besimet**: I përgjegjshëm, bashkëpunues, respekton rregullat, i sigurt;
**Njohuritë**: Shkëmben përvojat, identifikon, përshkruan, skicon;
**Shkathtësitë:** Diskuton në grup, pjesëmarrës aktiv, zbaton parimet.

**Si mund të bëhet vlerësimi i arritjeve të rezultateve të të nxënit përmes njësisë mësimore?**

Pasi keni përzgjedhur njësinë mësimore që do të zhvilloni në ditët në vijim, hartoni një plan vlerësimi për këtë njësi. Përcaktoni rezultatet e të nxënit (të njësisë, respektivisht orës), zgjidhni një teknikë të vlerësimit dhe caktoni kriteret e suksesit (kujto planifikimin e orës mësimore).

<u>Shembull i një modeli të një plani të vlerësimit për një njësi mësimore për secilin nxënës:</u>

**Fusha e kurrikulës /Lënda:** Edukatë muzikore
**Njësia mësimore:** Kënga "Dimri"
**Detyra kryesore me nxënës**: mësojnë dhe performojnë këngën
**Teknikë e vlerësimit**: Vëzhgimi
**Instrument:** Tabela vlerësuese e mësimdhënësit (mund të jetë listë kontrolli, shih shtojcën)
**Dëshmia:** Interpretim i këngës sipas kritereve të përcaktuara
**Rezultatet e të nxënit: Nxënësi:**

1. Këndon këngën me ritëm e intonacion të saktë;
2. Këndon sipas imitimit, individualisht dhe në grup.

**Kriteret e suksesit: Nxënësi:**

1. Këndon me ritëm dhe intonacion e me emocion;
2. Shqipton tekstin e këngës;
3. Lëviz në përputhje me ritmin, karakterin e këngës dhe shprehjen emocionale.

*Kujto! Rezulatat e të nxënit dhe kriteret e suksesit dalin nga RNSH, RNF dhe RNL*

**Tabela vlerësuese (instrument i vlerësimit) nga mësimdhënësi**

| **Kriteret e zbërthyera** | **1**<br>**Ka nevojë për përmirësim** | **2**<br>**I realizuar** | **3**<br>**Nivel i lartë** |
|---|---|---|---|
| **Ritmi dhe intonacioni, emocionet.** | Mundohet t'i shoqërojë të tjerët gjatë këndimit, ka probleme të theksuara në ritëm dhe intonacion por tregon interesim për pjesëmarrje dhe ka emocion. | Këndon me ritëm mesatarisht saktë dhe ka probleme me intonacion, por ka emocion). | Këndon me ritëm dhe intonacion të saktë e me emocion, emocionale. |
| **Tekstin e këngës** | Nuk e mban mend tekstin e këngës gjatë këndimit. | Shqipton tekstin me probleme. | Shqipton saktë tekstin e këngës. |
| **Lëvizjet me karakterin e këngës** | Lëviz por jo krejtësisht në përputhje me ritmin dhe karakterin. | Lëviz, por jo në përputhje me ritmin dhe karakterin e këngës. | Lëviz në përputhje me ritmin, karakterin e këngës dhe shprehjen. |

***Nxënësi:***

*Mund të caktoni nivele të ndryshme vlerësuese, dy, tri e me shumë nivele, ndoshta deri në pesë nivele*.

Gjatë vlerësimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve, me çka nxënësit vlerësohen me notë numerike duhet bazuar në elementet e vlerësimit të fushës së arteve, **shembull:**

**Kryesisht raporti i elementeve të vlerësimit në arte është**:
-Portfolio e punimeve (art figurativ) /Interpretimi artistik (këngë, melodi instrumentale) individualisht dhe në grup (60% i notës);

-Veprimtaritë/sjellja (pjesëmarrja) në klasë (10% i notës);
-Punimet e nxënësit / projektet jashtë shkollës/performancat në programet shkollore e jashtëshkollore (20% i notës);
-Njohuritë teorike mbi konceptet , mjetet shprehëse artistike etj. (10%  i notës).

Vlerësimi në fushën kurrikulare të artit kërkon kujdes të veçantë dhe mbështetet në parimin e individualizimit, ngase çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e ndryshme të shprehjes artistike. Andaj, në vlerësim duhet të përfshihet interesimi dhe prirja e nxënësit për forma të caktuara të shprehjes, kuraja, imagjinata,shprehja origjinale dhe kreative, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi etj. Arritjet në fushën e artit janë individuale, andaj edhe duhet të vlerësohen si të tilla, duke shfrytëzuar vlerësimin për motivim dhe inkurajim të zhvillimit të aftësive të tyre krijuese.

Në art duhet të vlerësohen interesimi dhe pjesëmarrja aktive (individuale dhe në grup) në aktivitete të ndryshme artistike që organizohen në klasë, në shkollë dhe në komunitet. Grupet e ndryshme muzikore, teatrore etj., që marrin pjesë në shfaqjet e shkollës, në ekspozitat individuale dhe grupore duhet të përfshihen në vlerësimin e nxënësve më të talentuar. Për nxënësit më pak të talentuar duhet vlerësuar interesimi dhe guximi për të provuar angazhimin e tyre në një nga format e ndryshme të të shprehurit artistik.

Instrumentet e ndryshme të vlerësimit në fushën Artet janë: portfolio e punimeve, pjesëmarrja në aktivitetet artistike në klasë, lojëra, kuize, prezantime publike në shkollë dhe jashtë saj, prezantimet artistike gjatë lëndëve të tjera etj.

Megjithatë, gjatë organizimit të vlerësimit të arritjes së rezultateve të të nxënit të fushës dhe të lëndës për tema të ndryshme vlerësohet veprimi ose niveli i veprimit të kërkuar brenda rezultatit. Kjo mund të ndryshojë varësisht nga tema, materiali, teknika etj.
**Në përgjithësi, vlerësimi në art është inkurajues dhe konstruktiv, e jo gjykues**.

***Mbani në mend:*** *Nuk munden të gjithë nxënësit të këndojnë mirë, të vizatojnë mirë apo të krijojnë punime kreative, ngase varet nga talenti, interesimi individual. Por, me rëndësi është që të gjithë nxënësit të kenë mundësinë të marrin pjesë në këto aktivitete të mësimit artistik, duke i nxitur të zhvillojnë aftësitë e tyre përjetuese, interpretuese dhe krijuese brenda mundësive (predispozitave) të tyre.*

**Vlerësimi për të nxënë**. Vlerësimi për të nxënë tashmë është pjesë e udhëzuesve për përmirësimin e praktikave në klasë, është pjesë e programeve për aftësimin e mësimdhënësve në shërbim. Ne nuk do të ndalimi në aspektet teorike, por vetëm po sjellim disa thekse të vlerësimit për të nxënë, për të siguruar se vlerësimi për të nxënë është kuptuar në esencë dhe për të lehtësuar aktivitetet praktike me mësimdhënës gjatë trajnimit ose zhvillimit profesional në këtë fushë.

Vlerësimi për të nxënë është instrumenti më i fuqishëm i vlerësimit, i cili gjeneron mësim. Ai "*...i jep mundësi nxënësit të bëhet nxënës pa frikën se do të dështojë. Krijohet një mjedis mësimor dhe ofrohen mundësi për nxënësit t'i praktikojnë shkathtësitë dhe të marrin komente specifike dhe përshkruese që u ndihmojnë ta përmirësojnë të mësuarit..*[1] *"*

Komentet kthyese të mësimdhënësit për nxënësin/it karshi të nxënit janë karakteristikë e veçantë e vlerësimit për të nxënë. *Hattie dhe Timperley e kanë propozuar një model të komenteve kthyese që shkon në katër nivele:* komente për detyrën (*p.sh. komente kthyese nëse përgjigjet ishin të sakta apo të gabuara, ose orientim për të marrë më shumë informacione*), komente për procesin e detyrës (*p.sh. komente kthyese lidhur me strategjitë e përdorura apo për strategjitë që mund të përdoreshin*), komente për vetërregullim (*p.sh. komente lidhur me vetë-vlerësimin apo vetëbesimin e nxënësit*) dhe komente për nxënësin si person (p.sh. deklarime se nxënësi është 'i mirë' ose 'i mençur'). Analiza e tyre vë në pah se niveli në të cilin është përqendruar komenti kthyes ndikon në efektivitetin e tij. Komentet kthyese për cilësinë e detyrës dhe komentet për procesin ose strategjitë e përdorura për kryerjen e detyrës janë më të dobishmet. Komentet që e tërheqin vëmendjen e nxënësve për strategjitë vetërregulluese apo aftësitë e tyre si nxënës mund të jenë efektive nëse nxënësit e kuptojnë se do t'i rrisin rezultatet në qoftë se dëshirojnë t'i shtojnë përpjekjet dhe t'i kushtojnë më shumë vëmendje. Komentet personale ('Vajzë e mirë!") nuk e tërheqin vëmendjen e nxënësit për të nxënit e tyre.[2]

Pra, ofrimi i komenteve kthyese nuk ka të bëjë me dhënien e lëvdatave, por ka të bëjë me:

---

[1] Sherry Bennett and Dale Armstrong; *Putting the Focus on Learning: Shifting Classroom Assessment Practices* (Chapter 13) f. 265

[2] David Lynn, Osman Buleshkaj dhe Selim Mehmeti (2012): Mësimdhënia dhe të nxënit. EU-GIZ, Prishtinë. Cituar sipas Susan M. Brookhart; "*Teacher Feedback in Formative Classroom Assessment*" f. 232.

**Aktivitetet - hapat:**

1. Lexoni në mënyrë individuale tregimin në vijim;
2. Diskutoni me kolegë mësimet e marra nga ky tregim;
3. Diskutoni me kolegë shembuj praktikë nga përvoja juaj me nxënës, të ngjashëm ose të përafërt me tregimin;
4. Përzgjidheni një përvojë të diskutuar në detaje dhe përshkruani rastin/shembullin në formë të tregimit – në pika kyçe;
5. Prezantoni shembullin para kolegëve të tjerë.

***Një tregim i vërtetë!***

Pas dymbëdhjetë vjetësh shkollë dhe gjashtë vjet në universitet, unë nuk mbaj mend ndonjë gjë që kam mësuar në lidhje me përgatitjet për provimin përfundimtar (vlerësimit përmbledhës). Por, e mbaj mend, sikur të ishte tani, përvojën time të parë me vlerësimin për të nxënë. Ma ofroi babai (i cili nuk ishte mësues).

Familja ime po përgatitej për pushimin e parë që e kishte bërë ndonjëherë larg shtëpisë. I kisha dhjetë (10) vjet. E kishim një automobil të vogël, i cili nuk i zinte të gjitha valixhet. Kështu që babai vendosi ta ndërtonim një arkë të hapur për valixhe dhe ta vendosnim në mbajtëset e sipërme të automobilit. Më pyeti nëse më pëlqente ta dizajnoja dhe m'i dha specifikat:

1. *I kishim dy dërrasa të cilat ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 30 centimetra të gjera. Këto dy dërrasa do të bëheshin pjesët anësore të arkës;*

2. *Pjesa e poshtme e arkës duhej të ishte me dërrasa më të holla me hapësirë ndërmjet veti që do të mundësonin kullimin e shiut nga arka në kulmin e automobilit në rast se na zinte shiu rrugës;*

3. *Dërrasat e holla do të formonin bazën e arkës dhe se arka do të montohej me anë të lidhëseve dado. Duhej t'i bënim 8 dërrasa të shkurtra prej 3 copave të dërrasave që ishin 2.5 metra të gjata, 2 centimetra të trasha dhe 10 centimetra të gjera.*

Kështu që i fillova t'i bëja llogaritjet dhe ta dizajnoja; "do të ishte një punë e lehtë, kështu mendoja". Pasi ia fillova të punoj e pashë se nevojitej më shumë sesa kisha menduar. Babai nuk më tha asnjëherë "Këtë e ke gabim". Ai do të më parashtronte pyetje si, "nëse do ta bësh arkën kaq të gjerë a do të përshtatej me hapësirën e mbajtëseve? "Nëse do t'i bësh dërrasat më të holla aq të gjata, a do të na mjaftojnë dërrasat? A më bënte vazhdimisht pyetje të cilat më bënin të mendohem 'brenda kontekstit'. Me fjalë të tjera, ai i referohej gjithnjë kritereve që i kishim vendosur, si të ishin objektivat mësimore në një orë mësimi. Brenda një dite e kisha dizajnuar

arkën. Dizajni funksionoi dhe e ndërtuam së bashku arkën. Isha shumë krenar dhe i gëzuar se “e kisha bërë atë”. Gjatë gjithë kohës po mësoja nën udhëzimet e babait.

*Reflektim lidhur me tregimin*

Ajo që kishte bërë prindi me fëmijën e vet ishte përdorimi klasik i vlerësimit për të nxënë, por është një shembull që mësimdhënësit mund ta marrin dhe ta përshtatin për nxënësit e tyre në situata të mësimit, kur synojnë të praktikojë vlerësimin për të nxënë. Sepse:

- Prindi gjatë gjithë kohës e inkurajonte fëmijën dhe i ofronte komente dhe sugjerime, të cilat nuk gjykonin, kishin fokus të qartë dhe ishin përshkruese;
- E angazhoi në procesin e dizajnimit;
- E ndihmoi t’i gjejë gabimet dhe kufizimet dhe sigurohej që fëmija e dinte se cili ishte hapi tjetër;
- Ndërsa, fëmija i merrte veprimet për t’i korrigjuar gabimet dhe e zotëronte procesin e vet të mësimit.

*Inkurajohen mësimdhënësit që të bëjnë të njëjtën gjë me nxënësit e tyre në detyra dhe aktivitete mësimore.*

***Aktivitet:*** *Analizoni planifikimet e mësimore me kolegë të fushës tuaj, bisedoni, strategjitë e vlerësimit, teknikat dhe instrumentet e përshtatshme për t’u përdorur për vlerësim. Identifikoni cilat rezultate do t’i vlerësoni nga RNSH, RNF dhe RNL, teknikat dhe instrumentet të cilat do t’i përdorni për vlerësim.*

### 4.4 Bashkëpunimi i mësimdhënësve, domosdoshmëri për zbatim të kurrikulës së re

Çelësi i suksesit të nxënësve qëndron në bashkëpunimin kolegial të mësimdhënësve. Kjo do të thotë që në mes të mësimdhënësve nuk duhet të ketë rivalitet negative, sepse të gjithë synojë zhvillimin maksimal të potencialeve të nxënësve; nuk duhet të ketë hezitim ndaj njëri-tjetrit, sepse të gjithë janë përgatitur për përkrahje të nxënësve; nuk duhet të hezitohet të kërkohet ndihmë nga njëri-tjetri për të ngritur profesionalizmin dhe performancën, sepse kjo bëhet për të mirën e nxënësve. Mos harro! **Transparenca eliminon çdo vështirësi**!

Zbatimi i filozofisë së KKK-së domosdoshmërisht kërkon bashkëpunimin në mes të mësimdhënësve. Bashkëpunim duhet të bëhet në nivel të Këshillit të klasës-klasave, por edhe të aktiveve profesionale.





Mësimdhënësit e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme, duhet bashkëpunojnë në mes vete, por edhe me mësimdhënësit e niveleve të tjera dhe të fushave të ndryshme kurrikulare. Ky bashkëpunimi duhet të reflektohet në planifikime mësimore që do të thotë se mësimdhënësit-et e klasës së njëjtë, por të paraleleve të ndryshme duhet bashkërisht të hartojnë planifikimet për shkallë dhe planifikimet vjetore për të vazhduar më pas në shkëmbimin e ideve dhe përvojave në hartimin e planifikimeve dymujore, të cilat mund të jenë edhe të ndryshme nga mësimdhënësit e paraleleve të ndryshme. Gjithashtu, mësimdhënësit-et duhet të ndihmojnë njëri-a-tjetrin-ën në edhe planifikimet javore.

Bashkëpunimi i mësimdhënësve duhet të reflektohet edhe në shkëmbimin e përvojave të metodologjisë së mësimdhënies, të vlerësimit, në krijimin dhe shkëmbimin e materialeve mësimore.

Mësimdhënësit mund të marrin iniciativa për ngritje profesionale brenda shkollës, duke mbajtur vetë punëtori për çështje të ndryshme që janë në funksion të mësimdhënies.

Mësimdhënësit e të gjitha fushave bashkërisht mund t'i përgatisin nxënësit edhe për gara të ndryshme, për kuize diturie, gara sportive, ekspozita dhe aktivitete të tjera që ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit dhe në arritjen e kompetencave të caktuar.

Gjithashtu, suksesin e zbatimit të KKK-së e forcon edhe bashkëpunimi me mësimdhënësit e shkollave të tjera, duke shkëmbyer përvojave, literaturë, linqe internetin, informata e njohurive të marra nga trajnimet e ndryshme.

Zbatimi me sukses i filozofisë së KKK-së së re, i bazuar në kompetenca / RNSH + RNF, është tejet i vështirë pa integrimin e dijeve, shkathtësive dhe mjeteve të përbashkëta ndër mësimdhënës në shkollë . Shumë gjëra nga fusha e arteve nuk mund të kuptohen si të vetme nga nxënësit nëse nuk bashkohen dijet edhe me fusha të tjera kurrikulare. Kjo shton domosdonë e bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve të fushave të ndryshme brenda një shkolle.

Bashkëpunimi i mësimdhënësve brenda lëndës së njëjtë dhe fushës së arteve për organizimin e aktiviteteve artistike me tematikë të përbashkët është i domosdoshëm. Ata mund të komplementojnë njëri-tjetrin për të realizuar një shfaqje, ku ka muzikë, skenografi, aktrim, vallëzim, etj.

Mësimdhënësit e fushës Artet duhet të bashkëpunojnë edhe me prindërit dhe komunitetin. Me rastin e festave të ndryshme p.sh. ata realizojnë së bashku ngjarje artistike e karakter të ndryshëm. Festat fetare, të fundvitit, ditë të caktuara (pastrimi i ambientit, Dita e Tokës, e ujit, Dita e fëmijëve etj).

# SHTOJCË

**Modele të planifikimeve të mësimdhënësve të shkollave pilot dhe materiale të mësimdhënies dhe të vlerësimit të përdorura nga ta.**

Ato mund të jenë të ndryshme nga shkolla në shkollë

**Shtojca 1 : Disa folje vepruese për hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit**

Gjetja e fjalëve të duhura për hartimin e rezultateve të të nxënit/kritereve të vlerësimit mund të jetë e vështirë, veçanërisht kur fjalitë duhet të përputhen me nivelin e përgjithshëm të përshkrimit. Lista në vijim mund të përdoret për t'ju ndihmuar në këtë proces. Fjalët janë të organizuara në nëntituj që korrespondojnë me astronominë e Bloom-it. Megjithatë, kjo renditje nuk paraqet kurrfarë hierarkie. Fjalët përbëjnë thjesht një listë të vokabularit të vjelë nga burime të ndryshme për t'ju ndihmuar në hartimin e rezultateve të të nxënit dhe kritereve të vlerësimit.

**Foljet që kërkojnë fakte për njohuritë**: Defino, përshkruaj, identifiko, emëro, listo, riprodho, përsërit, përzgjedh, deklaro, prezanto, ji i vetëdijshëm, nxjerr, organizo, rinumëro, shkruaj, prano, mat, nënvizo, ndërlidh, bashko.

